

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7715 E martë 20 Nëntor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**
Arsimi, kudo në botë, po përjeton ndryshime intensive. E, në këtë proces ndryshimi, pohohet jo pak, me dëshirën për të përballur sfidat dhe zhvillimet ...
Vijon në faqen 20

Nga PELLUMB KARAMETA
Çfarë e sfidon arsimin tradicional?


Opinion **Ditës**
Për herë të fundit, hallën time Manushaqe Prodani e kam parë pak para se të vdiste. Gjyshja më tha që ishte shtruar në Sanatorium, me ditë ...
Vijon në faqen 21

Nga DRITAN HILA
Historia e njeriut që çliroi Tiranën




Unaza e Re, FNSH merr në ruajtje zonën
Protestuesit përplasen me policinë, 6 vetë nën arrest. Banorët: Duam dëmshpërblim 100%

ARRSH: 70% e pronarëve janë sqaruar nga ne.
Opozita: Skandali, 40 milionë euro për 2.2 km rrugë
VALENTINA MADANI
Protesta e banorëve të zonës së Astirit në kryeqytet u shoqërua dje me tensione dhe përplasje fizike me policinë. Banorët bënë thirrje kundër qeverisë dhe Bashkisë së Tiranës dhe, gjithashtu, kanë kërkuar ...
Në faqen 3

INTERVISTA/ FLET KOSTA BARJABA: Ç'NDODH ME EMIGRANTET DHE FERMERET VENDIMI, EKSPERTI: JA SA DO TE RRITEN PENSIONET

Formula e saktë për përcaktimin e masës së pensioneve të pleqërisë. Sa do të jenë koeficientët e përlogaritjes në 2018-ën, tabelat e plota. Kriteret për të përfutur



(Në foto) Kosta Barjaba

PROJEKTBUXHETI
Guvernatori Gent Sejko: Kujdes me PPP, jo më shumë se 5% e të ardhurave
Në faqen 6

AVOKATI: APELOJME
Vrasja në Bllok, Gjykata e Apelit lë në burg pa afat Ervis Martinajn
Në faqen 7

LUFTA NDAJ MAFIAS
Kryeprokurori i Italisë: Kokaina nga Shqipëria në duart e kalabrezëve
Në faqen 11

STUDIVESJA
Alda Bardhyli: Telefonata Enver Hoxha-Kadare dhe raporti mes të dyve
Në faqet 14-15

FJALIMI PER SKENDERBEUN

Papa Françesku: Bashkëjetesa fetare në Shqipëri është e paçmueshme
Në faqen 21

GJYQI/ Vrasja e adoleshentit për një karikues: Ndërhyri për të shuar sherrin
"Marvin e vranë me thikë, pastaj i gjuanin me shkelma"
Dëshmia: Kushëririn e goditën me "flutur", ngriva kur e pashë në tokë

TIRANË-Tronditin dëshmitarët e vrasjes së studentit 22-vjeçar, Marvi Mihalit. Në procesin ndaj 4 të dyshuarve, gjykata e Tiranës dëgjoi dëshmitë e protagonistëve të ngjarjes së rëndë të ndodhur në korrik të vitit të kaluar. Armend Haxhiu shpjegoi përpara togave të zeza se



ishite ai që i shiti telefonin të pandehurit Dejvi Bitraj, por nuk i dorëzoi karikuesin e për këtë arsye pati debate mes tyre. Për t'u sqaruar ai tha se kërkoi ndihmën e Marvi Mihalit, i cili u vra krejt pafajësisht, pa pasur asnjë lidhje me konfliktet e mëparshme mes ...
Në faqen 10

KUVENDI KOMBETAR ZGJEDHJET

Në fundjavë mbahen zgjedhjet në degë ku do të përzgjidhen dhe kryetarët e rinj

Ekipi i ri i Bashës, më 15 dhjetor zgjedhjet e reja në PD

Ristrukturimi, kush rrezikon postet në parti

Valentina Madani

Partia Demokratike më 15 dhjetor mbledh Kuvendin Kombëtar, i cili u hap rrugë zgjedhjeve në të gjithë strukturën bazë dhe përcakton ekipin me të cilin Lulzim Basha synon fitoren e zgjedhjeve lokale dhe rikthimin e së djathtës në pushtet. Zgjedhjet e reja në PD përfshijnë të gjitha nivelet përjashtuar atë të kryetarit Lulzim Basha, i cili është rizgjedhur me afro 90 përqind të votave në këtë post. Zgjedhjet përfshijnë këshillin kombëtar, kryesinë, sekretariatit, si dhe dy nënkryetarët e partisë. Procesi i ristrukturimit nisi në shtator, ndërkohë që në të gjitha degët janë zhvilluar zgjedhjet për seksionet dhe grup seksionesh. Sipas afateve kohore të përcaktuara në statutin e Partisë Demokratike, por edhe bazuar në ndryshimet e bëra rishtazi në të, kreu i Partisë Demokratike Lulzim Basha, më 26 shtator urdhëroi krijimin e grupeve të punës për organizimin e zgjedhjeve në strukturat e Partisë. Të shtunën dhe të dielën do të mbahen zgjedhjet në degë ku do të përzgjidhen dhe kryetarët e rinj. Pjesa më e madhe e të deleguarve për procesin e ristrukturimit kanë sjellë në selinë qendrore të PD-së emrat e kandidatëve. Sipas sekretarit të përgjithshëm të PD-së Arben Ristani, "përbërje e re e Kuvendit Kombëtar të partisë Demokratike, e cila do të votojë për Këshillin e ri dhe më pas zgjedhjet në qendër për kryesinë dhe sekretariatet e PD". Ky proces i rifreskimit të strukturave të Partisë Demokratike vjen pas ndryshimeve në statutin e kësaj force politike të votuara në Kuvendin Kombëtar të Demokratëve në prill 2018. Në shtator kuvendit kombëtar i ka përfunduar mandatin ndërsa nënkryetarët dhe sekretariatit ka mandat deri në fund të nëntorit. Kuvendi kombëtar do të jetë vetëm zgjedhës për pas muaj më parë u bënë ndryshime statutores dhe nga ky forum do të dalë këshilli i ri kombëtar, i cili do të zgjedhë kryesinë e PD-së, nr. 2 të partisë, sekretarin e përgjithshëm, nënkryetarët dhe sekretariatit. Ethet e garës tashmë po ndihen në selinë e PD-së, ndërsa mbetet për t'u parë kush do të jetë ekipi i ri i Lulzim Bashës për betejën e zgjedhjeve lokale të qershorit dhe betejat e tjera elektorale. Gjatë procesit të zgjedhjeve me 15 dhjetor do të aplikohet parimi "një anëtar, një votë" që nga grupseksioni, deri tek kalimi i vendimeve në organet kolegjiale dhe pritet të forcojë partinë dhe demokritizojë vendimmarrjen. Janë kryesitë e degëve ato të cilat duhet të japin mendimin e



Kuvendi Kombëtar i PD-së

PROCESI

Zgjedhjet e reja në PD përfshijnë të gjitha nivelet përjashtuar atë të kryetarit Lulzim Basha, i cili është rizgjedhur me afro 90 përqind të votave në këtë post. Zgjedhjet përfshijnë Këshillin Kombëtar, Kryesinë, sekretariatit, si dhe dy nënkryetarët e partisë. Procesi i ristrukturimit nisi në shtator ndërkohë që në të gjitha degët janë zhvilluar zgjedhjet për seksionet dhe grup seksionesh.

"Ndryshimi vjen duke shkëputur krimin nga politika"

Basha thirrje shqiptarëve: Ne jemi shumica, të marrim fatin në duar

Kreu i opozitës Lulzim Basha fton shqiptarët që të marrin fatin në dorë e t'i japin fund keqeverisjes së Edi Ramës. Që ky plan të konkretizohet, kreu i opozitës kërkoj nga fermerët e Poshnjës në Berat që të bashkohen për të larguar më parë nga karrigia e pushtetit kryeministrin Rama. Basha iu bëri thirrje fermerëve të Poshnjës që për të përqaftuar ndryshimet ekonomike, duhet të ndryshojnë fillimisht gjendjen politike. "Pa ndryshuar gjendja politike, pa pasur një qeveri që e ka të lidhur fatin me ju dhe jo me banditët dhe kriminelët, mos prisni të ketë ndryshim as në tavolinën tuaj, as në xhepat tuaj, as në serat tuaja, as në arat tuaja. Një shprehje kam dëgjuar këto 3-4 javë që kam lëvizur: Na ka shkuar në palcë! Nuk ka



pse të na shkojë në palcë. Ne jemi shumica, ju jeni shumica. E jani ta marrim fatin tonë në duart tona!", deklaroi kreu i PD-së. Z. Basha u shpjegoi banorëve se me 2,2 miliardë euro që sot shkojnë në xhepat e oligarkëve mund të ndryshoheshin shumë gjëra në Shqipëri. "Me 2,2 miliardë euro, ne mund të arrinim fare lehtësisht të shpërdanim 150 milionë euro në vit për fermerët. Me 2,2 miliardë euro ne mund të arrinim të rrisnim pensionet 30 përqind për gjithë sh-

tyre për kandidaturat për këshilltar bashkiak dhe më pas të merret mendimi për kandidaturat për kryetar të pushtetit lokal, zgjedhjet për të cilët janë vetëm 7 muaj larg. Që prej Kuvendit Kombëtar të 28 prillit, urdhrat e kryetarit të Partisë Demokratike u kthyen në normë statutores. I tillë është edhe ai i 11 majit, i cili detronte mbylljen deri

më 30 qershor të zgjedhjeve në grupseksionet dhe seksionet e partisë, sipas parimit "një anëtar, një votë". Por nuk u zbatua urdhri që motivohej me zgjedhjet vendore pranë, e nevojën e qytetarëve për një ofertë për problemet socio-ekonomike, përballë një mazhorancë që demokritizojë e akuzojnë të kriminalizuar dhe të korruptuar. Për sh-

kak të axhendës politike të opozitës, e cila i ka nisur betejën për shkëputjen e politikës nga krimi, zgjedhjet e brendshme u shtynë sërisht ndërkohë që 15 dhjetori do të përcaktojë ekipin e ri të Lulzim Bashës me të cilin demokratët do të shkojnë drejt fitores së zgjedhjeve lokale dhe atyre të përgjithshme.



Protesta e banorëve tek Unaza e Re

Salianji përballë Veliajt? Deputeti i PD: Kjo nuk varet vetëm nga unë

Zgjedhjet lokale janë duke afruar, e partitë politike janë duke identifikuar kandidatët, të cilët do të garojnë në bashkitë e vendit. I ftuar në studion e Top Talk, deputeti i PD, Ervin Salianji u pyet rreth strategjisë që ka PD për zgjedhjen e kandidatëve për zgjedhjet lokale, nisur edhe nga deklarimet e kryetares së LSI, Monika Kryemadhi për kandidatët të përbashkët. "PD është e gatshme që të përballlet me kandidatët dhe platformën e saj në çdo qytet dhe lagje. Ne jemi në një bashkëpunim me të gjitha partitë opozitare. Për marrëveshje zyrtare do të ketë diskutime në forumet e PD. Për mendim tim, sot është Rama i vetëm, e në krahun tjetër janë të gjitha palët e tjera politike", u përgjigj Salianji. Por Tirana, mbetet fushë-beteja kryesore, e Salianji nuk i ka shpëtuar pyetjes nëse do të jetë ai që do vendoset përballë Erion Veliajt për bashkinë më të madhe në vend. "Skam ndonjë ambicie për të qenë kryetar i Bashkisë së Tiranës. Por kjo s'varet vetëm nga unë. Nuk ka ardhur koha për të thënë emrin e kandidatit, por Basha ka bërë edhe një listim të kushëve që duhet të ketë kandidatit që do të vendoset përballë Veliajt, apo ndonjë kandidatit tjetër", u shpreh Salianji.

PD: Të arrestohet! Rama po pengon hetimin ndaj Dakos

Deputeti Xhemal Gjunkshi përsëriti dje qëndrimin e PD-së se kryebashkiaku i Durrësit Vangjush Dako duhet të burgoset. Faktet, sipas tij gjenden në dosjen 339 dhe vërtetohen lidhjet e tij me bandën e Avdyllajve. Prej disa ditësh PD ka hedhur akuza ndaj kryebashkiakut të Durrësit. "Prej gati një muaji, qytetarët janë njohur me denoncimin e Partisë Demokratike se Vangjush Dako është peshku i madh i dosjes 339! Vangjush Dako është një nga personat kyç për blerjen kriminale të pushtetit ilegjitim të Edi Ramës. Shkarkimi i kryebashkiakut të Durrësit duhet të ishte veprimi i parë që duhet të kishte bërë një kryeministër i pakapur nga krimi. Arrestimi duhet të kishte qenë vendimi i menjëhershëm një prokurorie të pakapur nga qeveria dhe krimi. Vangjush Dako meriton të ndëshkohet me burg për blerjen e votave nëpërmjet bandave dhe për shpërblimin me tenderë, punë publike dhe favore të tjera për krimin që i siguroi votat. Në dosjen 339 ndodhen qindra faqe me përgjime që vërtetojnë lidhjet e bandës kriminale të qeverisë me bandën e Avdyllajve, në Durrës dhe Shijak"-deklaroi deputeti Xhemal Gjunkshi.



ARRSH: Janë sqaruar 70% e banorëve, të vijnë te ne dhe të marrin shpjegime për punimet

Unaza e Re, protestuesit përplasen me policinë, gjashtë të arrestuar

Banorët me flamur amerikan në duar: S'dorëzohemi

Valentina Madani

Protesta e banorëve të zonës së Astirit në kryeqytet u shoqërua dje me tensione dhe përplasje fizike me policinë. Banorët bënë thirrje kundër qeverisë dhe Bashkisë së Tiranës dhe, gjithashtu, kanë kërkuar dëmshpërblim 100% për banesat e tyre. Më pas, ata i kanë vënë zjarrin kaza-nëve të plehrave dhe janë konfrontuar me policinë. Disa protestues çanë rrethimin e kantierit të kompanisë për ndërtimin e Unazës së Re dhe u shoqëruan në komisariat. Në ditën e 16 të protestës së tyre banorët shprehen se do të mbrojnë shtëpitë e tyre, të cilat do të prishen për t'i hapur rrugë projektit të Unazës së Madhe. Banorët hoqën rrethimin në hyrje të Unazës së Re, por policia nuk i lejoi të bllokojnë sheshin. Tensionimi i situatës erdhi pas shoqërimit në komisariatet e policisë të 6 protestuesve. Mësohet se janë shoqëruar në komisariat protestuesit Gëzim Sadikaj, Edmond Frangu, Arben Qyrani, Armando Gishto, Shpëtim Billo, Paolo Ahmetenaj, nën moshën 18 vjeç. Pas disa minutave, situata është normalizuar, por banorët deklaruan se nuk do të dorëzohen. FNSH ka marrë në ruajtje kantierin e Unazës së Re duke krijuar një gardh. Me flamur amerikan në duar dhe me thirrje kundër qeverisë dhe kryetarit të bashkisë Erion Veliaj, protestuesit kërkuar dëmshpërblim 100% të pronave të tyre. Deputetë të opozitës ndodhen sërish pranë protestuesve që kanë hedhur dhe kapsolla e fishekzjarrë. Protesta e banorëve është në ditën e saj të 16. Në mbështetje të protestës janë edhe deputetë të PD-së dhe LSI. Banorët e Astirit, kërkojnë dëmshpërblim për prishjen e banesave që preken nga projekti për ndërtimin e Unazës së Madhe. Ndërkohë mëngjesin e djeshëm nisi prejra e disa pemëve. Banorët që preken nga projekti thanë se nuk do të lejojnë fadromat t'i afrohen banesave të tyre, se ato do t'i mbrojnë me armë. "Si pemët kërkon të na presë dhe neve. Projekti le të bëhet, por në të dëmshpërblemi me gmin-in e tregut 100%. Ne kërkojmë atë që na takon me ligj, me Kushtetutën e Shqipërisë. Unë banesën time do ta mbroj me armë. Nuk ka



Protesta e djeshme e banorëve tek Unaza e Re

Shpronësimi



YLLI MANJANI

"ARRSH-së i duhen pronat e atyre njerëzve. Ndaj duhet të shkojë derë më derë, t'i informojë të gjithë mbi projektin dhe mbi nevojën për shpronësim, procedurën dhe vlerësimet paraprake. Deklarimi "hajdeni këtu", është i poshtër, pa logjikë dhe i pambështetur askund! Arrogantë deri në pikën e fundit!", shprehet z.Manjani.

PD, Çupi: Qeveria po përpiqet të përçajë banorët e Astirit

Deputetja e PD-së, Dhurata Çupi, akuzoi dje qeverinë se po përpiqet të përçajë banorët tek Unaza e Re. Kjo akuzë e deputetes erdhi pas njoftimit të Autoritetit Rrugor Shqiptar kundrejt banorëve për informacionet që u nevojiten. Por sipas Çupit, banorët janë në të drejtën e tyre kushtetuese dhe ligjore për të protestuar dhe mbrojtur pronën e tyre. "Në kushtet e errësirës informuese, përmes akteve në kundërshtim të plotë me ligjet shqiptare, ARRSH u kërkon banorëve të paraqiten pranë këtij institucioni, me dokumentet që ata posedojnë, duke tentuar kështu tejkalimin e parashikimit ligjor për shpronësimet"- shkruan znj. Çupi. Kurse deputeti i PD Klevis Balliu iu bëri thirrje qytetarëve të mos përplasen me policët pasi ata po zbatojnë detyrën. Balliu i ka bërë thirrje drejtorit të policisë së Tiranës që të tërheqë efektivet për të mos provokuar më shumë banorët. "Asnjë prej këtyre nuk do t'iu prishë shtëpinë, po zbatojnë detyrën. I bëj thirrje drejtorit të policisë të tërheqë trupat mos të ketë provokime. Asnjë këtu se ka me Policinë e Shtetit. Ju jeni në të drejtën tuaj të mbroini shtëpitë tuaja. Por fajin nuk ua kanë këta policë",- iu tha Balliu, banorëve. Pas bisedimeve, banorët u tërhoqën disi, ndërsa forcat e FNSH qëndronin kordon në pjesën filltare të kantierit për Unazën e Madhe. Protestuesit para se të shpërndaheshin paralajmëruan se sërish sot në orën 17:00 do të protestojnë dhe se do të jenë edhe më shumë kundër vendimit të qeverisë për t'i nxjerrë nga banesat e tyre.

Vasili nxjerr dokumentet: Vjedhje gjigande me tenderin e Unazës

Kreu i deputetëve të LSI-së, Petrit Vasili denoncoi dje sipas tij vjedhjen gjigande dhe kriminale me tenderin e rrugës të Unaza e Re, ndërsa i bëri thirrje prokurorisë që të mos bëhet palë me megahajdutërinë". Sipas tij, janë bërë "tre tenderë për 2.2 km rrugë, 40 milionë euro për 2.2 km rrugë nga Pallati me Shigjeta tek sheshi Shqiponja". "Dhe në çdo ofertë vetëm dy konkurrenues dhe gjithmonë i dyti nga konkurrenuesit e ka ofertën zero lekë. Pra, gara ishte shitur në mënyrën më të turpshme dhe më korruptive. Një korupsion i tillë i pafytyrë është kaq i qartë, kaq kriminal, kaq i pacipë, siç është fytyra e hajdutërisë së shfrenuar të kësaj qeverie dhe këtij kryeministri. Tenderi i vjedhur dhe i manipuluar sheshit, çmimi më shumë se 18 milionë euro për km, tre oferta me zero lekë, si s'ka turp prokuroria që hesht është qartësisht pale me këtë vjedhje të qeverisë", shkruan Vasili në "Facebook". Ai thekson se prokuroria duhet të kishte filluar me kohë hetimin kryesisht pas denoncimeve publike me dhjetëra fakte skandaloze. "Prokuroria të ndahet një herë e mirë sa s'është shumë vonë nga vjedhja kriminale e qeverisë. Të nderuar qytetarë, më poshtë keni faktet që flasin vetë dhe le t'i shohë edhe prokuroria", tha z.Vasili.

"Shtëpitë s'do prishen", Berisha-Ramës: Pafytyrësi!

Sh-kryeministri, Sali Berisha publikoi dje një status në rrjetet sociale duke mos kursyer shefin e qeverisë, i cili kohë më parë deklaroi se shtëpitë e banorëve të Tiranës nuk do të prishen. Sipas Berishës, kryeministri në kohën kur i duheshin votat ai i mbronte shtëpitë, por shton se Edi Ramës tani i duhen paratë e drogës dhe nuk e ka mendjen tek qytetarët. "Dyfytirësia është pafytyrësi! Kur i duheshin votat Kallam Dësh-takut shtëpitë nuk prishen. Tani i duhen paratë e drogës, rrafshohen mbarë! Sb", shkruan Berisha. Në kohën e fushatave në takim me banorët, Rama deklaroi se banesat e tyre nuk do të prishen, sepse janë kursime dhe investime të bërë me gjak.

ngelur rrugë tjetër. Kjo ka shumë zgjidhje, por këta nuk pranojnë dialog", tha një prej përfaqësuesve të banorëve.

REAGIMI

Autoriteti Rrugor Shqiptar njoftoi dje se rreth 70% e pronarëve të prekur nga projekti janë pritur në një takim nga kreu i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik. 36 prej tyre kanë marrë përgjigje me shkresë zyrtare. Në një deklaratë për mediat, ARRSH kërkon nga banorët që të paraqiten pranë institucionit me dokumentet përkatëse për të marrë çdo informacion të

prekura nga projekti "Rehabilitim Mbikalimi Pallati me Shigjeta Unaza Shqiponja Loti 1, 2, 3, 36 prej tyre kanë marrë përgjigje me shkresë zyrtare nga ARRSH. Objekti që preken nga projekti "Rehabilitim Mbikalimi Pallati me Shigjeta Unaza Shqiponja Loti 1, 2, 3" janë 242, si-pas verifikimeve paraprake të bëra nga grupet e punës. Pjesa tjetër e banorëve që nuk janë paraqitur ende pranë institucionit të ARRSH-së janë të lutur të paraqiten për të marrë çdo informacion që u nevojitet",- thuhet në njoftimin e ARRSH.

VETINGU NË POLITIKË

MISIONI

PS do të presë opinionin e Komisionit dhe akuzon PD për inkoherencë në qëndrim

"Venecia" zbarkon në Tiranë, PD: Politikanët në veting si gjyqtarët

"Duhet të jetë i njëjti standard edhe për politikanët"

Komisioni i Venecias do të japë në dhjetor vlerësimin e vet mbi propozimin e paraqitur nga Partia Demokratike për vetingun në politikë. Para se të vendosë mbi thelbin e këtij debati dhe përputhshmërinë me standardet europiane, një përfaqësi prej 6 anëtarësh të Komisionit të Venecias kanë mbërritur në Tiranë ku kanë nisur një sërë takimesh me drejtues të institucioneve shtetërore dhe përfaqësues të partive parlamentare. Ata kanë takuar fillimisht nënkryetaren e Kuvendit, Vasilika Hysi dhe më pas krerët dhe përfaqësuesit e tjerë të grupeve parlamentare të Partisë Demokratike, Partisë Socialiste dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim. Takimet kanë qenë me detyrë të mbyllura dhe vetë ekspertët e Komisionit të Venecias nuk kanë bërë asnjë koment, ndërkohë që burime nga këto takime kanë bërë me dije se ata kanë marrë mendimet e secilës palë mbi propozimin për të zhvilluar veting edhe në radhët e politikës.

OPOZITA

Kryetari i Grupit Parlamentar të PD-së, Edmond Spaho e konsideroi takimin pozitiv, ndërsa bëri të ditur se i kishin kërkuar përfaqësuesve të Venecias zbatimin e të njëjtit standard që aplikohet në drejtësi dhe polici. "Ne parashtruan qëndrimin e PD-së, i cili në thelb është se nuk duhet të ketë dy standarde, por standardi që zbatohet për prokurorët dhe gjyqtarët duhet të aplikohet për politikanët, kur flasim për lidhje me botën e krimit të organizuar. Shpjeguar me fakte se asnjë reformë në Shqipëri nuk do të ketë sukses nëse nuk do të shkëputen lidhjet e politikës me krimin e organizuar", tha Spaho. Këtë qëndrim mbajti gjatë këtij takimi edhe kryetari i Grupit të LSI-së, Petrit Vasili, i cili tha se mbështeste nismën për të kaluar në veting gjithë politikanët. "Opozita ka propozuar standard të njëjtë, si vetingu i gjyqtarëve dhe prokurorëve. Fjalët e shumta për vetingun janë pa kupa-



MAZHORANCA

"Opozita vazhdon të jetë inkoherente me qëndrimet e saj sa herë që bëhet fjalë për Komisionin e Venecias. Këtu kam parasysh qëndrimet e liderit të opozitës, zotit Basha, në fazën e ndryshimeve kushtetuese sa i përket reformës në drejtësi"

Zgjedhjet vendore 2019 me Kod të vjetër

KQZ miraton planin orientues të zgjedhjeve, opozita bojkoton

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka nisur përgatitjen e zgjedhjeve vendore me dy anëtarë mangët. Përcaktimi i datës 30 qershor për zhvillimin e zgjedhjeve vendore ka vënë në lëvizje Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Në mungesë të dakordësisë mes mazhorancës dhe opozitës plani i orientimit do të mbështetet te Kodi i vjetër Zgjedhor. Kriza politike nuk ka prekur vetëm reformën zgjedhore. Vendimmarrja e KQZ është realizuar me pesë anëtarë pasi PD nuk ka pranuar të paraqesë emrat për dy anëtarë që i përkasin. Përfaqësuesit e PS në KQZ Eridian Salianji i bëri thirrje opozitës që të



plotësojë vendet vakante për të përgatitur procesin. KQZ vendosi miratimin e planit orientues, i cili parashikon të gjitha aktet të cilat duhet të nxjerr KQZ, në funksion të realizimit të zgjedhjeve, si dhe afatet,

tim. Qëndrimi është i qartë, opozita pro, rilindja kundër. Projekti duhet të votohet në parlament", tha Vasili.

MAZHORANCA

Ndërsa kryetari i Komisionit të Ligjeve, socialisti Ulsi Manja teksa tha se "Venecia" është taban i demokra-

cisë, ndërsa akuzoi Partinë Demokratike, për inkoherencë në qëndrime kundrejt këtij institucioni. "Opozita vazhdon të jetë inkoherente me qëndrimet e saj sa herë që bëhet fjalë për Komisionin e Venecias. Këtu kam parasysh qëndrimet e liderit të

referuar dispozitave të Kodit Zgjedhor. Po gjatë kësaj mbledhje KQZ ka bërë verifikimin e deklaramëve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve nga listat shumë-emërore për këshillat bashkiakë në zbatim të ligjit nr.138/2015. KQZ vendosi njoftimin e këshillave bashkiakë për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit kandidatëve të listave shumë-emërore, për plotësimin e vendeve vakante në këshillat bashkiakë si më poshtë: qarku Tiranë, Bashkia Kamzë, znj. Marsela Hysa, qarku Dibër, Bashkia Klos, znj. Marime Ademi, qarku Kukës, Bashkia Tropojë, z. Gjovalin (Xhovalin) Bibaj

opozitës, zotit Basha, në fazën e ndryshimeve kushtetuese sa i përket reformës në drejtësi. Në atë kohë tha nuk pranojmë asnjë lloj ndryshimi kushtetues pa opinionin e Komisionit të Venecias si taban i demokracisë parlamentare. Ndërsa dje zoti



Kryeministri Edi Rama në forumin "Ekonomia takohet me politikanët" dje në Vjenë

Bardhi: Ja çfarë na kërkuan ekspertët e "Venecias"

Iftuar në rubrikën 'Opinion' në News24, këshilltari ligjor pranë PD, Gazmend Bardhi ka treguar takimin me ekspertët e Venecias lidhur me iniciativën e PD për vetingun në politikë. Bardhi u shpreh se ekspertët e Venecias kanë kërkuar sqarime për iniciativën e ndërmarrë nga PD përpara se të japin opinionin e tyre. "Takimet me ekspertët e Venecias janë një procedurë përpara se të miratojnë një opinion. Pritet që në fund të miratohet opinionin për amendamentet kushtetuese të PD për vetingun e politikanëve. Ekspertët e Venecias janë takuar edhe me deputetët e PD dhe kanë kërkuar sqarime për iniciativën si dhe kemi shkëmbyer opinione dhe mendime. Ekspertët nuk shprehin qëndrime për iniciativën, por amendamenti kushtetues i depozituar nga PD për këtë iniciativë është një standard. Është e qartë se kjo është një masë e jashtëzakonshme që i përshkruan një situatë të jashtëzakonshme në Shqipëri. Disa politikanë kanë rënë në rrjetin e përgjimeve. Për të çliruar vendin nga krimi është propozuar amendamenti kushtetues për të cilin do të japë opinionin Venecia", tha Bardhi.

Komisioni do shprehet në dhjetor për kontrollin e politikanëve

Politika shqiptare do të duhet të presë mesin e muajit dhjetor për të mësuar opinionin e Komisionit të Venecias mbi kërkesën e opozitës për vetingun në politikë. Pak ditë më parë Komisioni i Venecias për News 24 bëri të ditur se tashmë janë përcaktuar datat kur do të diskutohet dokumenti, i cili vlerësohet thelbësor për vendimmarrjen politike në Tiranë. "Opinionin është pjesë e axhendës së sesionit plenar të Komisionit të Venecias, i cili do të mbahet në Venecia më 14 dhe 15 dhjetor 2018" Por më parë Komisioni i Venecias do të duhet të dëgjojë palët e interesuara në proces. Ndaj për këtë qëllim ka mbërritur në Tiranë një përfaqësi prej 6 anëtarësh për të mbledhur opinione dhe rrahur mendime mbi mundësitë e aplikimit të vetingut edhe në politikë.

Basha thotë një gjë krejt tjetër", tha Manja. Delegacioni vijoi takimet me Presidentin, ministrin e Drejtësisë dhe ambasadorin e Bashkimit Europian, ndërsa do të ketë takime edhe me kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, kryetarin e ILDKPI-së, Ganaj dhe

kreun e Euralius, Agnes Bernhard. Venecia u vu në lëvizje në fillim të tetorit, me kërkesë të kryeparlamentarit Gramoz Ruçi, drejtuar presidentit Gianni Buquichio, ku i kërkon opinionin për qëllimin dhe legjitimitetin e vetingut në politikë.



Kryeministri shqiptar: Jemi shumë të përkushtuar ndaj bashkëpunimit mes nesh

Rama në Austri, Kurz: BE, e plotë vetëm me anëtarësimin e Ballkanit

Integrimi, kryeministrat e rajonit mbledhen në Vjenë

Bashkimi European është i plotë vetëm kur Ballkani të jetë pjesë e tij. Kështu u shpreh dje kancelari i Austrisë, Sebastian Kurz, gjatë forumit që u zhvillua në Vjenë me temë "Ekonomia takohet me politikën", i cili bëri bashkë në një takim kryeministrat e Ballkanit Perëndimor, ndërsa i vetmi që ka munguar është shefi i ekzekutivit maqedonas, Zoran Zaev për shkak të situatës politike në Shkup. Në takimin e organizuar nga kancelari austriak, Sebastian Kurz ishte i pranishëm edhe Komisioneri european për Politikën e Fqinjësisë dhe Zgjerimit, Johannes Hahn. Në përfundim të takimit, gjatë konferencës për shtyp, kancelari Kurz garantoj edhe një herë vendet e Ballkanit për mbështetjen që Austria si vend që mban Presidencën e Bashkimit European, aspiratës së tyre integruese. "Austria është një partner i rëndësishëm për vendet e Ballkanit Perëndimor. Ne kemi një lidhje të fortë historike, ekonomike, politike, kulturore dhe njerëzore me këtë rajon, ndaj mendojmë se BE do të jetë e plotë vetëm kur vendet e Ballkanit Perëndimor të jenë anëtarë. Për këtë arsye mbështesim vendet e Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt BE-së dhe jemi fokusuar veçanërisht në këtë rajon gjatë presidencës sonë të BE. Sot kemi mundësi të përqendrohem te tri çështje me rëndësi. E para, rruga e rajonit drejt BE-së; e dyta, bashkëpunimi i domosdoshëm rajonal dhe e treta, zgjidhja e konflikteve bilaterale", tha kancelari austriak, Sebastian Kurz. Ndërkohë, kryeministri Rama ndërsa falënderoi kancelarin Kurz për organizimin e këtij takimi, theksoi se vendet e Ballkanit janë të angazhuara që të bashkëpunojnë për të çuar përpara këtë aspiratë të të gjithë popujve që kryeministrat pjesëmarrës në këtë takim përfaqësojnë. "E para, jemi shumë të përkushtuar ndaj bashkëpunimit rajonal dhe jemi shumë mirënjohës për punën mbikëqyrëse të komisionerit Hahn dhe e dyta, jemi duke u përballur me sfidat e bashkëpunimit dhe kuptojmë që ky është një proces ku asgjë nuk është e lehtë dhe asgjë nuk të jepet si e mirëqenë", tha kryeministri Rama.



Kryeministri Edi Rama dje në Vjenë

TAKIMI
"E para, jemi shumë të përkushtuar ndaj bashkëpunimit rajonal dhe jemi shumë mirënjohës për punën mbikëqyrëse të komisionerit Hahn dhe e dyta, jemi duke u përballur me sfidat e bashkëpunimit dhe kuptojmë që ky është një proces, ku asgjë nuk është e lehtë dhe asgjë nuk të jepet si e mirëqenë", tha kryeministri Rama.

Meta: NDI, e përkushtuar për forcimin e zërit publik

Presidenti Ilir Meta priti dje në një takim të veçantë drejtorin e Institutit Demokratik Kombëtar (NDI) për Europën Qendrore e Lindore, Robert Benjamin. Njëpër një postim në rrjetet sociale, kreu i shtetit publikoi një fotografi nga takimi, ndërsa vlerësoi rolin që luan NDI në forcimin e zërit qytetar. Ai theksoi se roli i NDI-është është shumë i rëndësishëm, sidomos në vende ku është e domosdoshme ndërgjegjësimi i qytetarëve për të luajtur një rol edhe më të madh në forcimin e demokracisë. "Pata kënaqësinë të takohesha me drejtorin e Institutit Demokratik Kombëtar (NDI) për Europën Qendrore e Lindore, Robert Benjamin. Fatmirësisht ka ende institucione si NDI, që mbeten të përkushtuara për forcimin e zërit publik si shtëri ndaj demokracisë dhe shtetit ligjor", shkroi Presidenti Meta në "Facebook".



Papa, audiencë për Shqipërinë: Ndhimoni të rinjtë të mos largohen

Papa Françesku i ka kushtuar dje një audiencë private një delegacioni të shtetit shqiptar, të kryesuar nga kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, së bashku me një përfaqësi të besimeve fetare shqiptare e arbëreshe. "Shqipëria është pjesë integruese e Evropës e përmes traditave të saj më fisnike, dokumenton origjinën e qytetërimit të saj", është shprehur Ati i Shenjtë gjatë këtij takimi. Ai theksoi se nevojën e politikave të duhura që do mundësojnë që të rinjtë të jetojnë dhe punojnë në vendin e tyre. "Ky vend kërkon një zhvillim të vërtetë e të balancuar, në mënyrë që brezat e rinj të mos detyrohen të zgjedhin rrugën e emigracionit, duke çuar në dobësimin e aftësive të vendit, që janë thelbësore për zhvillimin e saj human e civil", tha Papa Françesku. Më tej, ai shtoi se lidhja e miqësisë dhe marrëdhënieve mes Shqipërisë e Vatikanit sot janë rripërtërirë.



Zgjerimi i BE, në prioritetet e presidencës austriake

Hahn: Krijimi i zonës ekonomike rajonale, parakusht për integrimin

Komisioneri european për Politikën e Fqinjësisë dhe Zgjerimit, Johannes Hahn përsëriti faktin që Austria e ka vendosur çështjen e zgjerimit të BE-së me vendet e Ballkanit si një prej përparësive kyçe të presidencës së saj europiane. Duke folur pas takimit të djeshëm në Vjenë, Hahn theksoi se Forumi "Ekonomia takohet me politikën", i organizuar nga kancelari austriak është një dëshmi e qartë e këtij përkushtimi. "Së pari, jemi shumë të lumtur që kemi zgjedhur këtë si përparësi dhe e dyta, jo vetëm që e kemi zgjedhur, por kemi bërë hapa konkretë në këtë drejtim në këtë takim të fortë. Një prej tematikave të sotme ishte puna për krijimin e një zone ekonomike rajonale, si parakusht për in-



tegrimin e mëtejshëm në tregun e përbashkët europian", tha Hahn. Për këtë, ai theksoi se është e rëndësishme të rrezojnë barrierat, qofshin formale apo informale, por edhe të prezantohen elemente të reja bashkëpunimi në sketorë si ai energjisë. "E rëndësishme është që të rritet volumi tregtar midis vendeve dhe mund të sho-

him që për herë të parë nga 2016 në 2017 u verifikua një rritje e lehtë që është premtuese, por duhet t'ju them që në 10 vitet e fundit, volumi tregtar i vendeve të Ballkanit Perëndimor me Bashkimin European është dyfishuar në 46 miliardë euro e kjo tregon sa potencial ka në këtë rajon, sidomos duke mbajtur parasysh që këto vende kanë një mesatare rritjeje dy herë më të lartë se mesatarja e BE-së", theksoi Hahn. Më tej, ai tha se është e rëndësishme që të gjenden mënyra për të shfrytëzuar dhe mobilizuar potenciale që ekzistojnë në të gjitha vendet e Ballkanit dhe për këtë, ai nënvizoi se është e rëndësishme që vendet të tregohen më të shpejta për të gjetur dakordësinë midis tyre për një numër çështjesh, duke rritur më të bashkëpunimin ndërrajonal.

jepet si e mirëqenë", tha kryeministri Rama. Gjithësi, ai u shpreh i sigurt se vendet e Ballkanit do jenë në

gjendje t'i kalojnë të gjitha vështirësitë për t'u dhënë qytetarëve të tyre atë që meritojnë. "Jam personal-

isht dhe në emër të të gjithë shqiptarëve, mirënjohës ndaj kancelarit Kurz për qasjen e tij të qartë në lidhje me perspektivën europiane të vendeve të Ballkanit dhe gjithashtu për betejën e tij të vendosur për të hapur për Kosovën procesin e liberalizimit të vizave, që shprej shumë do të konkretizohet të paktën pas zgjedhjeve europiane", u shpreh Rama.

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA shpall ankandin, faza e parë - për shpëlljen e pasurisë së palajshme për të cilën ka vënë hipoteke NBG BANK, me këto të dhëna:

Tsuall Zk 3064 nr. pasurisë 80/2/1 vq1.2 fq.240 94 m2 ndërtesa 250 m2. në pronësi të Ali Ibrahim Alushi ndodhur në adresën Prush, Tiranë

Çmimi me të cilin fillon ankandi është në vlerën 12.000 (dymbëdhjetë mijë) EUR.

Ankandi zhvillohet në datën 05.12.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor me Adresë: Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21.Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890 CEL. 069137499.

Deputetja e PD-së denoncon dështimin e ekonomisë Tabaku, akuza qeverisë: Buxheti i Shtetit, në skemë piramidale

Deputetja e PD-së, Jorida Tabaku, denoncoi dje dështimin e ekonomisë shqiptare nën drejtimin e qeverisë "Rama", teksa e cilësoi buxhetin e vitit të ardhshëm, një skemë piramidale. Sipas saj, skemat e dështuara dhe të konfirmuara si dështim të PPP-ve u çuan në një stad tjetër, duke përfshirë në një skemë piramidale të gjithë Buxhetin e Shtetit. "Sot Shqipëria ka një borxh publik 71% të PBB-së, ndërsa vetëm PPP-të e dhëna deri më tani përbëjnë 12% të PBB-së. Këto skema janë kontrata e përjetshme, që qeveria ka lidhur me oligarkët për të kaluar përjetësisht paratë e shqiptarëve në xhepat e tyre dhe më pas xhepat e qeveritarëve", shkruan Tabaku në "Facebook".



Deputetja e PD-së, Jorida Tabaku

Ajo shtoi se pasi u dhuron kontrata disa milionë euro në xhepat e koncesionarëve oligarkë dhe më pas në xhepat e qeveritarëve të lidhur me to, qeveria një gjoga reformë për të rritur taksat për qytetarët duke sh-

ar varfërinë dhe duke prodhuar më shumë pa-barazi. "Një vit më parë e paralajmëruam, por ata vazhduan me kokëfortësinë e tyre, duke ndërmarrë këtë nismë me pasoja të frikshme për ekonominë shqiptare. Ballona e borxhit tanimë është kokëposhtë, vitin tjetër borxhi pritet të shkojë më shumë se 83% e PBB-së, ndërsa taksat janë rritur më shumë se 5 miliardë USD. Bizneset do të mbyllen, duke marrë me vete në humerë ekonominë dhe të ardhurat e gjithsecilit prej nesh, ndërsa qeveria shfaq filmin me zë të propagandës", tha Tabaku.



Ministri Ahmetaj në Beograd me homologun

Marrëveshje me Serbinë, lehtësohen procedurat për eksport-importin

Në kuadër të një vizite zyrtare në Serbi, ministri i Financave, Arben Ahmetaj, u prit në një takim nga homologu serb Sinisa Mali. Gjatë takimit, dy zyrtarët diskutuan mbi mundësitë e bashkëpunimit në fushën e tregtisë dhe doganave, me synim eliminimin e barrierave në tregtinë e mallrave mes dy vendeve. Dy bashkëbiseduesit u dakordësuan në lehtësimin e procedurave dhe reduktimin e dokumenteve të import-eksportit dhe transitit të mallrave, ndërsa shprehën nevojën për të bërë një hap para në njohjen reciproke të certifikatave veterinarë dhe fitosanitare mes dy vendeve. Dy ministrat vlerësuan rolin e Shqipërisë e Serbisë si rol kyç në rajon, ndërsa u shprehën se prioritet absolut do të jetë ekonomia, duke u kthyer në shembull të bashkëpunimit ekonomik e politik në rajon. Ata theksuan se nëse dy vendet bashkëpunojnë mes tyre, rajoni vetëm fiton.

Gent Sejko vlerëson pozitivisht ekonominë: Ndodhemi në një trajektore pozitive zhvillimi

Guvernatori i BSH jep sugjerimet për projektbuxhetin

"PPP-të e kontraktuara të jenë konform programit strategjik afatmesëm"

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, i pranishëm në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave ka bërë vërejtjet dhe sugjerimet e tij në lidhje me projektbuxhetin për vitin 2019. Sikundër edhe më parë, guvernatori gjykon se ekonomia shqiptare ndodhet në një trajektore pozitive zhvillimi. Sipas BSH-së, ritmi i rritjes ekonomike është përsheptuar gjatë tre tremujorëve të parë të vitit aktual, pjesërisht edhe si rezultat i situatës së favorshme hidrike. Punësimi është rritur dhe norma e papunësisë ka rënë, ndërsa bilancet financiare të familjeve, bizneseve dhe sektorit bankar shfaqen në përmirësim. Po kështu, treguesit kryesorë të balancave makroekonomike janë përmirësuar. "Inflacioni mesatar i është afruar më tej objektivit gjatë vitit 2018, pavarësisht ndikimit negativ që ka pasur forcimi i shpejtë i kursit të këmbimit. Deficiti i llogarisë korrente ka ardhur në rënie, kryesisht si pasojë e rritjes së eksporteve shqiptare; treguesi i kredive me probleme ka zbritur në nivelin 12.9%, në reflektim të përmirësimit të bilanceve të sektorit real, por edhe të



Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko

masave të marra për adresimin e këtij problemi dhe së fundi, raportimet fiskale tregojnë se deficitit buxhetor mbetet në nivele historikisht të ulëta dhe se borxhi publik ka ardhur në rënie. Të gjithë treguesit e mësipërm sugjerojnë se pozicioni ciklik i ekonomisë shqiptare është në përmirësim. Me fjalë të tjera, ekonomia është duke lëvizur gradual-

isht drejt ekuilibrit", - u shpreh guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko. Me gjithë këtë, guvernatori parajtoi versionin për skenarët e rrezikut. Ai tha se vlerësimi i ndikimit të goditjeve të mundshme negative në ekonomi apo në të ardhurat publike duhet të shoqërohet me identifikimin e masave që duhen marrë në drejtim të reduktimit të shpenzimeve,

për respektimin e vlerës së deficitit buxhetor, ndërsa u fokusua më shumë në vlerësimin e rrezikut që vjen nga programet e Partneritetit Publik-Privat, apo ndryshe PPP-të. "BSH sugjeron se shmangiet nga kërkesat e ligjit për pagesat vjetore të PPP-ve deri në nivelin 5% të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës, do të përballohen nëpërmjet rritjes

Guvernatori



SUGJERIMI PER PPP

"Gjej me vend të theksoj dhe një herë nevojën për përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale të njëjësive që administrojnë vlerësimin, kontraktimin dhe monitorimin e këtyre projekteve, sidomos sa i takon anëz ligjore dhe financiare të tyre. Gjithashtu, PPP-të e kontraktuara në lëmin e investimeve publike duhet të jenë konform programit strategjik afatmesëm e afatgjatë të investimeve, sikundër janë identifikuar në programet e zhvillimit të vendit", - tha Sejko.

së të ardhurave. Banka e Shqipërisë gjykon se, përtej këtij mekanizmi rregullues në funksion të respektimit të tavanit ligjor, rritja e mundshme e deficitit buxhetor duhet të shmanget nëpërmjet reduktimit të shpenzimeve buxhetore. Për më tepër, ky reduktim duhet të targetojë në maksimumin e mundshëm sektorët buxhetorë, të cilët prodhojnë këto shmangie. Sanksionimi i këtij parimi i shërben ruajtjes së balancave buxhetore, ruajtjes së balancave në shpërndarjen ndërsektoriale të fondeve dhe disiplinimit të kontraktimit të kë-

tyre programeve. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë shpreh nevojën e zbatimit të standardeve më të mira në fushën e kontabilizimit të ndikimit të tyre në treguesit e borxhit", tha guvernatori. Ai bëri edhe disa sugjerime mbi rritjen e efektivitetit dhe të qëndrueshmërisë së financave publike, mbi ritmin e konsolidimit fiskal në afatin e mesëm, sistemin tatimor, pasurimin e mëtejshëm të rregullit fiskal, mbi ritmin e realizimit të shpenzimeve buxhetore gjatë vitit dhe mbi administrimin e programeve të Partneritetit Publik-Privat.

Njoftim shtjete me ankand

Shoqëria përmbarimore "AA Bailiff" shpk, zhvillon ankandin e III-të, për shitjen e pasurisë së paluajtshme, Trulli 128 m2 dhe ndërtesë 81 m2, me Nr. pasurie 2/339, ZK 8511, vol. 15, fq. 127, në pronësi të Oemal Murrut Skora e regjistruar në ZVRPP Durrës.

Cmimi i ankandit të tretë është EUR 40,118 (dyzetë mijë e njëqind e tetëmbëdhjetë euro).

Ankandi zhvillohet dt. 03.12.2018, ora 16:00 në adresën Rruga e Kavajës, Ndërtesa 27, Hyrja 1, Kati III-të, Tiranë.

Kontakt: cel. 0688012846, ose në adresën e email: aabailiff@gmail.com.

NJOFTIM ANKANDI

1. Shoqëria e Përmbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k njofton: Shpalljen e Ankandit të I-të, për shitjen e pasurisë ULLISHTE, me sip.3,400 m², Zona Kadastrale: 1615

Numri i Pasurisë: 327/1, Vol. 1, Faqe 221, ndodhur në Fier-Shegan Lushnje, në pronësi të: z.Bajram Sefer Skraqi, i datëlindjes 14.11.1967. Ankandi i pasurisë fillon me ciminin fillestar në vlerën 2,720,000 (dy milion e shtatëqind e njëzet mijë) LEKË.

Ankandi do të zhvillohet më datë 21.11.2018, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përmbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k, në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.telefon 042322227, email: givinth@hotmail.com.

SHPALLJE ANKANDI

Datë 23.11.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel.067 201 9460/068 904 9202, e.mail: besnik.bajraktari@gmail.com. Shpall ankandin e tretë për pasurinë e paluajtshme të dorëzuaritë Baftjar Alush Murto.

"Trulli + Ndërtesë" me sipërfaqe trulli 300 m² dhe ndërtesë 81 m², regjistruar në regjistrin hipotekor me volumn nr. 3, faqe 76, zona kadastrale 3316, nr. pasurisë 987, adresa: Shalës, Sarandë.

Cmimi fillestar i ankandit të tretë është në shumën 907.200 (nëntëqind e shtatë mijë e dyqind) lekë. Ankandi do të zhvillohet në ambientin e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

KORÇË - Pak muaj pas vdekjes së 27-vjeçarit Enea Ftoj në komisariat në Korçë, i ati i tij ka dorëzuar prova të reja në Prokurori, të cilat sipas tij vërtetojnë dhunën që ka ushtruar policia ndaj djalit. Tomorr Ftoj pohoi se ka dorëzuar në organin e akuzës CD dhe filmime, ku duket dhuna në trupin e të ndjerit Enea Ftoj. "Provat e reja vërtetojnë dhunën e policisë ndaj djalit tim. Çova në Pro-



27-vjeçari Enea Ftoj

Vdekja e 27-vjeçarit Enea Ftoj në komisariat, prindërit: Kemi prova të reja, e dhunoi policia

kurori CD me filmime, ku duket dhuna në trupin e Eneas. I kërkova prokurorisë të pyesë si dëshmitare gruan, të cilën grabiti im bir, pasi ajo ka parë kur policia dhunoi Enean në mes të pazarit. Unë akuzoj 8 policë të komisariatit të Korçës për vdekjen e djalit. Policia fshehu rrobat dhe këpucët me gjak të Eneas", - u

shpreh i ati i të ndjerit. Ndërkohë, edhe nëna e 27-vjeçarit kërkoi të zbardhet e vërteta, ndërsa akuzon punonjësit e policisë për vdekjen e djalit. "Të zbardhet e vërteta. Policët që e rrahën djalin për vdekje duhet të ndëshkohen. Enean ma vrau policia, s'vdiq për shkaqe natyrore. Nëse nuk zbardhet e vër-

ta, do hakmerrem", - deklaroi Mimoza Ftoj. Që pas ngjarjes, familjarët kanë kundërshtuar ekspertizën mjeko-ligjore për vdekjen e 27-vjeçarit, i cili ishte ndaluar me akuzën e vjedhjes dhe gjeti vdekjen në ambientet e komisariatit të Korçës, ditën që ai do të dilte në gjykatë për vendosjen e masës së sigurisë.

Ngjarja e 4 tetorit, ja akuzat e prokurorisë ndaj biznesmenit 36-vjeçar

Vrasja në ish-Blok, Gjykata e Apelit lë në burg pa afat Ervis Martinajn

I pandehuri kërkoi për herë të dytë lirinë, avokati: Do të apelojmë në Gjykatën e Lartë

TIRANË

Gjykata e Apelit të Tiranës ka pranuar kërkesën e Prokurorisë, duke lënë në burg afat 36-vjeçarin Ervis Martinaj, i cili dyshohet të jetë përfshirë në ngjarjen e ndodhur në ish-Blok më 4 tetor të këtij viti. Treshja gjyqese e kryesuar nga gjyqtari Hysni Demiraj ka hedhur poshtë vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës, e cila kishte vendosur për herë të dytë masën e sigurisë "Arrest me burg" me afat 30-ditor ndaj Martinajt. Vetë i pandehuri (Martinaj), përmes avokatit të tij mbrojtës kërkoi lirinë në Gjykatën e Apelit, duke apeluar masën e vendosur nga shkalla e parë e gjyqësorit. Ndërkaq, organi i akuzës kërkoi vendosjen e masës së arrestit me burg pa afat për Martinajn, pasi sipas tij, ka prova e fakte që rëndojnë pozitën e biznesmenit. Ndërkohë, avokati mbrojtës i 36-vjeçarit tha se do të apelojë masën në Gjykatën e Lartë, gjykatë e cila është reduktuar në 4 anëtarë, si pasojë e procesit të vetingut dhe gjasat që kërkesa të merret në shqyrtim janë të pakta, gjithsesi deri atëherë pritet për t'u parë se si do të rrjedhë ky proces.

HETIMI DHE AKUZAT

Fillimisht hetimet ndaj Martinajt nisën për vrasjen e ndodhur në lokal "Monopoli", në ish-Blok, ku mbeti i vrarë Fabian Gaxha, ndërsa Ervis Martinaj dhe shoku i tij, Eljon Hate u plagosën. Prokuroria ngriti akuzë të rënda ndaj tij, si ajo e pastrimit të parave, falsifikimit të dokumenteve, fshehjes së pasurisë dhe organizimit të lojërave të paligjshme. Nga ana tjetër, Prokuroria e kryeqytetit ka zbuluar se biznesmeni Ervis Martinaj disponon edhe një pasaportë me emër tjetër të Republikës së Kosovës. Për këtë arsye, sipas Prokurorisë, ekziston rreziku që Martinaj të arratiset jashtë vendit, në rast se gjykata vendos një masë shtrënguese sigurimi më të lehtë se arresti me burg. Në kërkesën për caktim mase sigurie "Arrest me burg", Prokuroria thotë se Martinaj ka lëvizur jashtë vendit me këtë pasaportë dhe ka dyshime se ajo mund të jetë



Ervis Martinaj



Vendi ku ndodhi ngjarja

AKUZAT

Fillimisht, hetimet ndaj Martinajt nisën për vrasjen e ndodhur në lokal "Monopoli" në ish-Blok, në të cilin mbeti i vrarë Fabian Gaxha, ndërsa Ervis Martinaj dhe shoku i tij, Eljon Hate u plagosën. Prokuroria ngriti akuzë të rënda ndaj tij, si ajo e pastrimit të parave, falsifikimit të dokumenteve, fshehjes së pasurisë dhe organizimit të lojërave të paligjshme.

falsifikuar nga vetë i hetuari, që gjendet në masën e "Arrestit me burg" me afat. Gjithashtu, Prokuroria e Tiranës deklaroi në seancën e parë se ka dërguar në Kosovë një letërporosi, pasi dyshohet se Martinaj ka kryer edhe veprën penale të falsifikimit të dokumenteve. Konkretisht, Prokuroria kërkoi nga Kosova që të administrojë. Por, prova më e fortë në dorë të Prokurorisë konsiderohet ekspertiza e kryer nga grupi izraelit në telefonin e Ervis Martinajt. Prokurorët thonë se janë evidentuar të dhëna të thirrur disa persona "që të vinin menjëherë në lokal in Redi Popeskut të armatosur". Për vrasjen në zonën e ish-Blokut janë arrestuar Ervis Martinaj, Eljon Hate dhe Geldo Hoti, ndërsa janë në kërkim shtetasit: Ervin Mata, Fabio Allushi, Mevil Bilo dhe A. Boshnjaku.

Mbrëmjen e 4 tetorit të këtij viti, pas një konflikti me armë zjarri mes grupit të Ervis Martinajt dhe grupit të Ervin Matës mbeti i vrarë Fabian Gaxha, ndërsa u plagos vetë Martinaj dhe shoku i tij Eljon Hate. Pas ngjarjes së rëndë që tronditi banorët e kryeqytetit, fillimisht u tha se përplasja me armë ndodhi për shkak të ngacimit të këngëtares së njohur Elvana Gjata. Për vrasjen në zonën e ish-Blokut janë arrestuar Ervis Martinaj, Eljon Hate dhe Geldo Hoti, ndërsa janë në kërkim shtetasit Ervin Mata, Fabio Allushi, Mevil Bilo dhe A. Boshnjaku.

NGJARJA

Vrasja e 11 civilëve, familjarët e ish-të përndjekurve politikë përkujtojnë viktimat e vitit 1943

GJIROKASTËR - Familjarë dhe ish-të përndjekur politikë kanë përkujtuar në Gjirokastrë një prej ngjarjeve më të rënda, ekzekutimin e 11 civilëve prej skuadrave partizane në 1943-shin. Masakra e 75 viteve më parë është ngjarje, e cila shënoi dhe fillimin e njëres prej periudhave më të errëta të ndëshkimit dhe eliminimit të antikomunistëve.

Mijëra vetë vuajtën dënimet prej vitit 1944 deri në vitin 1967 në burgun famëqek të kalasë së Gjirokastrës, që u kthye në simbol terrori për qytetin. Banorët të qytetit dëshmojnë se të ekzekutuarit pa gjyq u gruposën në varre masive në pjesën e pasme të kalasë. Ende askush nuk di të thotë se ku gjenden këto eshtra, ndërsa mungon njohja zyrtare dhe bërja publike e së vërtetës

për fatin e tyre. Për Nebil Çikën, përfaqësues i Shoqatës së të Përndjekurve Politikë, kthimi i eshtrave të martirëve antikomunistë për familjet është detyrim moral dhe e drejtë humane e tyre. Arjeta Kokalari, përfaqësuese e të përndjekurve lokalë dhe iniciatore e këtij aktiviteti, tha se ata që u sakrifikuan për idetë përdimorë të ndryshme prej komunistëve, ende perseku-



tohen. Familjarët e viktimave që morën pjesë në aktivitetin përkujtimor sollën momente tronditëse të krimeve të kryera nga komunistët. Kjo ngjarje e rëndë është lënë në heshtje gjatë regjimit komunist, aq sa në Gjirokastrë janë të pakta ata që e njohin atë.

PENSIONET E PLEQËRISË

INTERVISTA

Flet eksperti: Fermerët të subvencionohen. Çfarë do të ndodhë me pensionet e emigrantëve

Kosta Barjaba: Vendimi i qeverisë, sa do të rritet masa e pensionit për të moshuarit

"Kriteret që duhet të plotësoni për të përfituar"

Voltiza Duro

Sipas vendimit më të fundit të qeverisë, pensionistët kanë të drejtë të përfitojnë një rritje pensioni prej 2.8%. Në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", eksperti i njohur, prof. dr. Kosta Barjaba tregon se vitet e fundit janë ndjekur politika shumë të kontrolluara për rritjen e pagave dhe pensioneve, por sipas tij raporti kontribuues me përfitues është shumë kritik e kjo bën që fondit i pensioneve, gati 50% financohet nga buxheti i shtetit. Më tej Barjaba thekson të gjitha kriteret që duhet të plotësojnë të moshuarit për të përfituar pension pleqërie si dhe mënyrat për të rritur masën e pensionit. Ndërkohë eksperti bën me dije se masa minimale e pensionit është 130 mijë lekë të vjetra, por problemi i madh në Shqipëri është që gati 80% e pensioneve janë minimale, pra skema e pensioneve shkon drejt pensionit minimal.

Sa është numri i pensionistëve dhe kontribuuesve në Republikën e Shqipërisë?

Në vendin tonë ka rreth 650 mijë pensionistë si dhe rreth 720 mijë kontribuues. Raporti kontribuues me përfitues është shumë kritik, gati 1.1 me 1, në një kohë që raporti duhet të ketë minimalisht 2 kontribuues për 1 person që trajtohet me pension. Në Shqipëri ka rreth 1 milionë e 600 mijë persona që punojnë dhe vetëm 720 mijë prej tyre paguajnë kontribute, pra më shumë se gjysma nuk paguajnë kontribute dhe nuk janë në sistemin e pensioneve.

Cilat janë arsyet e këtij raporti kritik midis kontribuuesve dhe pensionistëve?

Ky raport kritik vjen për të shkaqe kryesore: së pari, për shkak të strukturës demografike të popullsisë; e



Prof. dr. Kosta Barjaba

NUMRI I PENSIONISTEVE

Në vendin tonë ka rreth 650 mijë pensionistë si dhe rreth 720 mijë kontribuues. Raporti kontribuues me përfitues është shumë kritik, gati 1.1 me 1, në një kohë që raporti duhet të ketë minimalisht 2 kontribuues për 1 person që trajtohet me pension. Në Shqipëri ka rreth 1 milionë e 600 mijë persona që punojnë dhe vetëm 720 mijë prej tyre paguajnë kontribute, pra më shumë se gjysma nuk paguajnë kontribute dhe nuk janë në sistemin e pensioneve.

së dyti, një tjetër arsye është edhe shkalla e punësimi; e shkak i tretë është për shkallën e lartë të informalitetit. Në kemi shumë njerëz që punojnë, por nuk paguajnë kontribute, sepse mendojnë që të marrin për momentin lekët në dorë e nuk mendojnë për të ardhmen që mund të ngelin pa pension. Kjo ndodh pavarësisht se kontributet e sigurimeve shoqërore janë të përballueshme, nuk janë shumë të larta. Kjo bën që fondit i pensioneve, gati 50% financohet nga buxheti i shtetit, sepse qeveria nuk mund të lejë pensionistët pa pensione dhe kjo e rëndon.

Nëse do të kemi një raport të duhur mes kontribuuesve dhe pensionistëve, a do të ndikojë kjo në rritjen e pensioneve?

Në bazë të ligjit kemi një sistem kontributiv që mbështetet në kontribute dhe në praktikë kemi një model që gati gjysma e pensioneve përballohet nga

buxheti i shtetit. Gjithë përpjekjet janë bërë që të rriten fondit që vjen nga kontributet dhe të ulet fondit që vjen nga buxheti i shtetit. Ky është elementi themelor që do të na çojë te rritja e pensioneve dhe rregullimet që i bëhen moshës së pensionit. Gjithë defekti i skemës së pensioneve vjen nga fakti që kemi pak kontribuues. **Sa do të jetë rritja e pensioneve sipas vendimit më të fundit të qeverisë?** Qeveria këto 4-5 vitet e fundit ka ndjekur politika shumë të kontrolluara për rritjen e pagave dhe pensioneve. Faktikisht nuk janë rritur, por janë indeksuar. Dihet që pensionistët kanë nevojë e dëshirojnë masa të larta pensionesh, por sistemi ekonomik në Shqipëri ka nevojë që të jetë i balancuar dhe të shëndoshet, kjo është zgjidhja më e mirë. Kjo pasi rritja e pensioneve është e kontrolluar në mënyrë që të fuqizohet dhe të mos

rrezikohet skema e pensioneve. Kështu akumulohen disa burime që favorizojnë mirëqenien e qytetarëve.

Cilat janë kriteret për të përfituar pension pleqërie?

Individi që të përfitojë pension pleqërie duhet të ketë mbushur 35 vite punë me kontribute dhe të ketë mbushur moshën e përcaktuar; respektivisht 60 vjeç e 8 muaj për gratë dhe 65 vjeç për burrat. Parimi themelor i skemës së pensioneve është: "Sa paguan, aq përfiton".

Sa është masa e pensionit të një përfituesi që ka mbushur moshën për të dalë në pension dhe trajtohet me këtë pagesë?

Masa minimale e pensionit është 130 mijë lekë të vjetra, por problemi i madh në Shqipëri është që gati 80% e pensioneve janë minimale, pra skema e pensioneve shkon drejt pensionit minimal. Kemi shumë pak pensione mesatare dhe shumë më pak pensione të larta. Kështu që duhet të zgjidhet problemi i kontributeve që njerëzit të punojnë e të derdhin kontribute. Edhe pse vitet e fundit janë mbi 200 mijë kontribuues të rinj.

Si mund të përfitohet një masë më e lartë pensioni, cila është procedura? Për ata që punojnë vlen të theksoj se duhet të përfitojnë nga skemat suplemen-

KRITERET PËR PËRFITIM

Individi që të përfitojë pension pleqërie duhet të ketë mbushur 35 vite punë me kontribute dhe të ketë mbushur moshën e përcaktuar; respektivisht 60 vjeç e 8 muaj për gratë dhe 65 vjeç për burrat. Parimi themelor i skemës së pensioneve është: "Sa paguan, aq përfiton".



lekë të vjetra. Qeveria e hoqi këtë tavan pasi një individ mund të paguante 5-fishin e kontributeve të atij që kishte pension minimal, dhe merrte vetëm dyfishin e pensionit minimal, pra paguanin më shumë kontribute dhe nuk merrnin atë që u takonte. Kjo bëri të mundur që mos të kishte evazion kontributiv, dhe madje më parë punëdhënësit nuk deklarorin pagat reale. Heqja e tavanit dhe e bëri skemën e pensioneve më të drejtë dhe më të ndershme, pra çdo njeri do të marrë pension, aq sa ka paguar kontribute.

Shumë herë qeveria dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore u ka bërë thirrje fermerëve të sigurohen. Si paraqitet situata në këtë sektor?

Dua të ndalem pak te fermerët të cilët po tregojnë një rezistencë shumë të madhe për të paguar kontributet, sepse mendojnë vetëm për sot. Qeveria ka bërë propagandë të kjo kategori për t'i bindur, por është shumë e vështirë. Në këtë rast është e nevojshme të merren masa. Sistemi i bujqësisë ka nevojë për një program subvencionesh afatgjatë që fermerët të subvencionohen, të marrin NIPT-in dhe pjesë e këtij subvencioni të jenë edhe sigurimet shoqërore në mënyrë që të bëhen pjesë e tregut të punës. Nëse nuk zgjidhet kjo, është e vështirë të zgjidhen problemet e tjera.



Tabela e plotë/Formula e saktë për përcaktimin e masës së pensioneve të pleqërisë

Sa do të jenë koeficientët e përllogaritjes së pensioneve në 2018-ën

Masa që iu takon për vitet e punës me kontribute

Voltiza Duro

Shumë pensionistë në mbarë vendin shpesh herë pretendojnë se iu takon një pagesë më e lartë pensioni sesa ajo që marrin realisht, e ka jo pak raste kur bëjnë ankime për rritjen e masës. Gazeta Shqiptare publikon sot mënyrën e saktë të përllogaritjes së masës së pensionit, sipas formulës bazuar në koeficientët e rinj të indeksimit të pagave që prej vitit 1994 deri në vitin 2018. Të gjithë pensionistët duhet të dinë se sipas ligjit "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", pensioni i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe një shtesë dhe pagat e individëve që kanë derdhur kontribute shumëzohen me koeficientin përkatës, i cili përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Ndërkohë në vitin 2015 dhe në vazhdim, pagat mbi të cilat janë paguar kontributet, pas indeksimit të tyre vit pas viti, me koeficientët vjetorë të përcaktuar, nuk mund të jenë më të larta se trefishi i pagës minimale të indeksuar, të vitit përkatës, për pagat nga viti 1994 deri në 31.12.2001 apo më të larta se paga maksimale, e përcaktuar për efekt të pagimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore në vitin 2014 e në vazhdim, për pagat nga viti 2002 e në vazhdim. Pensioni i pleqërisë është përfitim i një të ardhure kur individit e humbet aftësinë për punë, e kjo jo për shkak të gjendjes shëndetësore, por për efekt të moshës. Mbi moshën dhe gjendjen e një personi janë përcaktuar e vlerësuar dhe kriteret e marrjes së pensionit të pleqërisë, bazuar në ligjin 7703. Ky i fundit nënkupton trajtimin me përfitime afatgjatë të grupeve të interesit (individët kandidatë për të dalë në pension), të cilët është mirë që të kenë sa më shumë vite pune me kontribute. Për të përfutur pension duhet që kandidati të ketë jo më pak se 15 vite pune si për gratë dhe për burrat. Ndërkaq, ky pension merret kur burri kalon moshën 65 vjeç, e kur gruaje mbush moshën 60 vjeç e 8 muaj për vitin 2018-të. Por moshja e daljes në pension për gratë është fleksibel, pasi në 2019-ën, moshja e daljes në pension për gratë do të jetë 60 vjeç e 10



Foto Ilustruese

Vendim të Këshillit të Ministrave. Koeficienti i indeksimit para vitit 1994, aktualisht është 8.59.

KOEFICIENTËT E INDEKSIMIT

Koeficientët e indeksimit janë ata koeficientët që kërkojnë që pagën mbi të cilën janë paguar kontributet, ta aktualizojnë e ta sjellin në nivelin e vlerës së pagës sot, pra ti heqin efektin "gërryes" të inflacionit. Paga e një mësuesi që ka filluar punën me kontribute në 1975-ën, deri në janar në 94-ën, me gjithë indeksin e ndryshimit që kanë ndodhur, është e tillë që shkon 4110 lekë. Kjo pagë, indeksohet sot me një koeficient 8.59. Pra, ajo pagë mësuesi që ka qenë 7 mijë lekë të vjetra, po të aktualizohet sot del 360 mijë lekë të vjetra. Edhe ky indeks është i përshkallëzuar, e fillojnë nga 94' deri në momentin që del në pension. Viti 2018 nuk ka indeks, kurse viti 2014, 2015 kanë koeficientët respektivë. Pasi bëhet indeksimi, formula sesi llogaritet baza e vlerësuar mesatare është formula e bazës mesatare të vlerësuar të përdoruar, pra merren pagat për periudhën deri në vitin 1994, llogaritet një pagë e kjo ponderohet me vitet e punës. Individit edhe mund të ketë ndryshuar pozicionin pune që ka pasur rrogë më të lartë, por edhe kjo indekskohet e del vlerë më e lartë. Në këto kushte gjithë periudha ponderohet, e individit i del një pagë mesatare bazë e vlerësueshme, e cila shumëzohet me 40%, në rastet kur ka punuar 40 vite (1% për çdo vit pune). Pas kësaj del një vlerë së cilës i shtojmë edhe pensionin social dhe marrim vlerën përfundimtare të pensionit të pleqërisë. Nëse baza mesatare e vlerësuar del në vlerë më të madhe, po ashtu do të rezultojë edhe pensioni. Kjo është mënyra më e thjeshtë për llogaritjen e pensionit. Në rast se marrim në mënyrë hipotetike që një punonjës para vitit 1994 ka një vjetërsi kontributive prej 15 vitesh dhe paga mesatare e indeksuar rezulton në një shumë prej 25 000 lekë dhe mbas vitit 1994 ka një vjetërsi kontributive prej 22 vitesh, me një pagë mesatare të indeksuar prej 30 000 lekësh, atëherë baza e vlerësuar do të llogaritet: Baza e vlerësuar = (15*25 000 lekë + 22 * 30 000 lekë): 37 (vite gjithsej) = 28 000 lekë. Pensioni mujor = (6750 * 37/35,7) + (1/100 * 37*28 000) = 6 996 + 10 360 = 17 356 lekë.

FORMULA E LLOGARITJES

Formula e përllogaritjes së pensionit të pleqërisë është: Pension social (bazë) plus një shtesë që është 1% për çdo vit sigurimi, për çdo vit punë, të bazës mesatare të vlerësuar, për gjithë periudhën që individit ka paguar kontributet. Një qytetar që ka filluar punën në vitin 1975 deri në 2018-ën, pa ndërprerje, pra ka 43 vite pune me kontribute. Pensioni do të llogaritet nga viti 75' kur individit ka filluar punë për herë të parë, deri në 2018-ën me pagat që ai ka gëzuar. Ndërkohë në rastin kur një individ ka qenë mësues për 40 vite dhe ka pasur një pagë mësuesi, duhet që patjetër këtë funksion që ka pasur ta ketë të shprehur qartë në librezën e punës. Pra, nuk i kërkojnë vërtetime pagash nga viti që ka filluar punën, por i kërkojnë vetëm një librezë pune e pastër, e plotësuar sipas dispozitave të kohës dhe e pakorrigjuar, e pandërhur brenda saj. Ky është një dokument themeltar mbi të cilin llogaritet pensioni para vitit 93'. Këto paga referuese i shërbejnë individit nga dita që ka filluar punë deri në 31 dhjetor të 1993-it e këto paga kanë koeficientët e vet të indeksimit. Baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi. Për periudhën e sigurimit nga data 1.1.1994 e në vazhdim, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merren shu-

FORMULA E LLOGARITJES

Formula e përllogaritjes së pensionit të pleqërisë është: Pension social (bazë) plus një shtesë që është 1% për çdo vit sigurimi, për çdo vit punë, të bazës mesatare të vlerësuar për gjithë periudhën që individit ka paguar kontributet.

KOEFICIENTËT E INDEKSIMIT TË PAGAVE	
Për pagat referuese, deri më 1.1.1994	8.59
■ Për pagat e vitit 1994	8.59
■ Për pagat e vitit 1995	6.92
■ Për pagat e vitit 1996	5.37
■ Për pagat e vitit 1997	5.37
■ Për pagat e vitit 1998	4.48
■ Për pagat e vitit 1999	3.64
■ Për pagat e vitit 2000	3.31
■ Për pagat e vitit 2001	2.83
■ Për pagat e vitit 2002	2.62
■ Për pagat e vitit 2003	2.34
■ Për pagat e vitit 2004	2.13
■ Për pagat e vitit 2005	1.93
■ Për pagat e vitit 2006	1.76
■ Për pagat e vitit 2007	1.67
■ Për pagat e vitit 2008	1.48
■ Për pagat e vitit 2009	1.36
■ Për pagat e vitit 2010	1.30
■ Për pagat e vitit 2011	1.25
■ Për pagat e vitit 2012	1.20
■ Për pagat e vitit 2013	1.16
■ Për pagat e vitit 2014	1.00

Ish-kreu i Hipotekës: S'jam i kërcënuar, të zbardhet ngjarja!

Durrës, paralajmërohet me bombë false drejtori i Përgjithshëm i Hekurudhave, Ani Dyrmishi

DURËS - Një pako e dyshimtë, e cila u gjet mëngjesin e djeshëm pranë vendparkimit të automjetit të drejtorit të Përgjithshëm të Hekurudhave, Ani Dyrmishi, rezultoi të ketë qenë një alarm fals për vendosje eksplozivi. Nga ekspertiza e kryer rezultoi se shishja me ngjyrë të errët nuk përmbante lëndë të tillë, por nitrat. "Sot rreth orës 08:30, në lagjen nr.4, në një parking mjeteve u konstatua një pako, e dyshuar si lëndë plasëse. Në vendin ku u gjet pako ishte parkuar mjete tip 'Pasat' me targa AA 070 TP, në përdorim nga shtetasi A.D. me detyrë drejtor i përgjithshëm i Hekurudhave. Në momentin që ka lëvizur mjedin, ai nuk e ka konstatuar pakon e dyshimtë. Nga konkluzionet e para të ekspertëve antiexploziv, re-



zulton se pakos së dyshuar i mungonin disa elemente për të qenë lëndë plasëse. Grupi hetimor po punon për sqarimin e rrethanave të ngjarjes. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit

Gjyqësor Durrës për verime të mëtejshme për veripren penale 'Kanosja për shkak të detyrës', thuhet në njoftimin zyrtar të Policisë Vendore të Durrësit. Ndërkaq, në lidhje me ngjar-

jen në fjalë ka reaguar edhe vetë kreu i Hekurudhave (ish-drejtor i Hipotekës së Durrësit, Ani Dyrmishi. Ai deklaroi se nuk ka pasur kurrë kërcënime dhe se mjetin e parkon në vende publike dhe lëviz i lirë në qytet gjatë gjithë kohës.

DEKLARATA E DYRMISHIT

"Sot, si qytetar i Durrësit, por edhe si person që mbaj funksion drejtues pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhës Shqiptare, çmtoj të arsyeshme të sqaroj opinionion publik në lidhje me pasqyrimin në media të gjetjes së një lende, të dyshuar si lëndë



Drejtori i Përgjithshëm i Hekurudhave, Ani Dyrmishi

plasëse në lagjen nr.4 të qytetit të Durrësit, lagje ku unë banoj. Unë nuk disponoj vend parkimi privat, si rrjedhojë në përditshmërinë time, e parkoj mjetin në vende parkimi publik. Kurrë nuk jam ndërjerë i kërcënuar Kam ecur dhe vazhdoj të ec i lirë në qytetin tim gjatë gjithë kohës. Figura ime si qytetar, por edhe si drejtues i lartë i HSH, kurrsesi nuk lidhen me ngjarjen e sotme. Unë nuk kam asnjë konflikt personal apo konf-

likt në lidhje me detyrën që unë mbaj, administrator i përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Hekurudhës Shqiptare. Gjatë ushtrimit të detyrës, kurdoherë jam mbështetur dhe do të vazhdoj të respektoj e zbatoj vetëm ligjin sot dhe në të ardhmen. Padyshim, nxis dhe pres nga organet ligjzbatuese të hetojnë e sqarojnë rrethanat e ngjarjes dhe të vihen përpara drejtësisë personat përgjegjës".

Gynter Jaupi: Grupi i Bitrajve na kërcënoi "Do t'ju therim të gjithëve"!

Tronditin në gjyq dëshmitarët: Ja si u vra për një karikues Marvi Mihali

Joslin Shata: Kushëririn e goditën me thikë flutur, ngriva kur e pashë të shtrirë në tokë

TIRANË

Tronditin dëshmitarët e vrasjes së studentit 22-vjeçar, Marvi Mihali. Në procesin ndaj 4 të dyshuarve, gjykata e Tiranës dëgjoi dëshmitë e protagonistëve të ngjarjes së rëndë të ndodhur në korrik të vitit të kaluar. Armend Haxhiu shpjegoi përpara togave të zeza se ishte ai që i shiti telefonin të pandehurit Dejvi Bitraj, por nuk i dorëzoi karikuesin e për këtë arsye pati debate mes tyre. Për t'u sqaruar, ai tha se kërkoi ndihmën e Marvi Mihalit, i cili u vra krejt pafajësisht, pa pasur asnjë lidhje me konfliktet e mëparshme mes grupeve të të rinjve. "Në 27 korrik i shita një celular Dejvi Bitraj, duhet t'i dorëzoja edhe karikuesin. Duke qenë me punë në Spille, u ktheva dy ditë më vonë. Ne nuk ishim sqaruar për çështjen, ndaj Dejvi me fyu dhe u ndjeva i poshtëruar. E lamë të takoheshin dhe unë telefona Marvin dhe i kërkova të vinte me mua. Në vendin që kishim caktuar erdhi Devis Bitraj. Ishte i nxehur. Kisha vendosur, do i jepja lekët për karikuesin, por u ndjeva nën tension. Më shau nga familja dhe unë e godita me grusht. E kam gjetur veten pastaj tek fundi i rrugës, isha duke u rrahur me çunat, më qëllonin vazhdimisht", tha dëshmitari. Përmes dëshmisë së tij, ai la të nënkuptohej se personat me të cilët ai ishte në konflikt ishin organizuar dhe qëndruan në pritje. Ndërsa, Xhulio Mema nxori detaje të reja në dritë, kur foli për një person, sipas tij i veshur me bluzë të bardhë, që i kërcënonte se do t'i vriste të gjithë. Ai tha se nga grupi tjetër, dy persona mbanin thika në duar, porse një gjë të tillë nuk e ka deklaruar më herët, pasi i është bërë presion nga oficerët e policisë gjyqësore. Gjykata dëgjoi

TENSION NË GJYKATË

Në seancën e djeshme gjyqësore, dëshmitarët patën kontradiktat në thëniet e tyre sa i përket vendit ku ishin takuar me njëri-tjetrin dhe faktit nëse kishin shkuar të gjithë bashkë në vendin e ngjarjes, apo të ndarë. Seanca u shoqërua me momente tensioni mes avokatëve, dëshmitarëve dhe prindërve të viktimës, të pranishëm në seancë si palë e dëmtuar.



Viktima Marvi Mihali

vrasjen e Marvi Mihalit të pandehur janë marrë katër persona, kushërinjët Dejvi dhe Eugen Bitraj si dhe vëllezërit Marsel e Kridens Alla, ndaj të cilëve rëndon akuza e vrasjes me paramen-

dim kryer në bashkëpunim. Në seancën e djeshme gjyqësore, dëshmitarët patën kontradiktat në thëniet e tyre sa i përket vendit ku ishin takuar me njëri-tjetrin dhe faktit nëse kishin shkuar të

AKUZA

Dëshmitari Xhulio Mema nxori detaje të reja në dritë, kur foli për një person, sipas tij i veshur me bluzë të bardhë, që i kërcënonte se do t'i vriste të gjithë. Ai tha se nga grupi tjetër, dy persona mbanin thika në duar, porse një gjë të tillë nuk e ka deklaruar më herët, pasi i është bërë presion nga oficerët e policisë gjyqësore.

SHKURT

2500 euro për të kaluar kufirin, kapen 2 trafikantët

DURËS - Policia Kufitare në Durrës ka marrë masa shtesë për parandalimin dhe goditjen e kalimit të paligjshëm të kufirit. Si rezultat i kontrolleve të shtuara janë kapur 6 shtetas, të cilët tentuan të kalonin Portin e Durrësit duke iu shmangur kontrollit të dokumentacionit. Sipas bluve, këta persona rezultuan me probleme për të lëvizur në hapësirën Shengen, ndaj janë ndëshkuar me masë administrative 20 mijë lekë të reja gjobë secili. Ndërsa, janë arrestuar në flagrancë dy drejtues kamionësh, të cilët kundrejti vlerës 1500-2500 uro për person kishin fshehur në kamionët e tyre dy shtetas për të kaluar në mënyrë të paligjshme kufirin. Gjithashtu, është ndaluar edhe një shtetas e shpallur në kërkim ndërkombëtar nga drejtësia italiane.

Abuzimet me rrugën, bie akuza e korrupsionit ndaj Dashamir Xhikës

TIRANË - Gjykata e Krimeve të Rënda ka shpallur moskompetencë lidhur me dosjen e korrupsionit me autostradën Tiranë-Elbasan. Hetimi i është deleguar Prokurorisë së Tiranës, e cila do të kryejë veprimet hetimore jo më për korrupsion për zyrtarët e arrestuar, por për akuzën e shpërdorimit të detyrës. I arrestuar për këtë çështje është ish-kreu i Autoritetit Rrugor, Dashamir Xhika, i cili dje kërkoi ndryshimin e masës që e mban në qeli prej 10 muajsh. Por seanca është shtyrë, pasi mungonin prokurorët e çështjes. Më herët, Gjykata e Krimeve të Rënda ka ndryshuar masat e sigurisë nga arrest me burg, në arrest shtëpi për dy ish-vartës të Xhikës, Aksel Qurduka dhe Albens Alite.

Kushtet e këqija, të dënuarit në burgun e Burrelit kërcënojnë me grevë urie

BURREL - Të dënuarit në Burgun e Burrelit kanë shprehur shqetësimin për kushtet e këqija me të cilat përballen çdo ditë teksa vuajnë dënimin. Ata kanë kërcënuar se në rast se nuk përmirësohet shërbimi në

ambientet e burgut, do të hyjnë në grevë urie. Por, kërkesa e tyre për të hyrë në grevë urie ka hasur në kundërshtimin e fortë të drejtorit të këtij institucioni, Fatjon Kurti, i cili thotë se është në negociata me të dënuarit. "Sapo

dola nga qelitetë e të burgosurve, jam në negociata. Ne po punojmë dhe po lyejmë burgun. Nëse duan të futen në grevë urie sipas ligjit, ata duhet të firmosin. Jemi në negociata", u shpreh kreu i Burgut të Burrelit.

Kreu i Antimafies: Ndrangheta është shtrirë në veri të Europës

Kryeprokurori italian: Kokaina nga Shqipëria, në duart e mafies kalabreze

De Raho: Mafiet, sipërmarrje që ndikojnë në ekonomi

Federico Calfiero De Raho, kryeprokurori i Antimafies italiane, ka konfirmuar sërish ditën e djeshme lidhjet mes trafikantëve shqiptarë të drogës e mafies kalabreze, Ndrangheta. Gjatë një konference me të gjitha strukturat e prokurorive italiane, ai ka theksuar fuqinë ekonomike të mafies italiane, e shtirë pothuajse në të gjithë Europën dhe që përmes shoqërive 'offshore' dhe investimeve në biznesin e lojërave të fatit, riciklon paratë e pista duke influencuar tregjet ekonomike kudo qofshin. "Mafiet nuk janë më ashtu siç imagjinohehin një herë e një kohë. Janë sipërmarrje në të gjitha drejtimet, me pasuri të pakufishme, që ndikojnë në ekonominë reale", ka deklaruar dje



kryeprokurori i Antimafies dhe Antiterrorizmit italian, Federico Calfiero De Raho, gjatë konferencës vjetore "Masat parandaluese ndaj kapitalit, legjislacioni e praktikat e veprimt", mbajtur në qytetin e Venecias. "Mafia kalabreze, Ndrangheta - tha ai - kontrollon një ekonomi

FEDERICO CALFIERO DE RAHO

"Mafiet nuk janë më ashtu siç imagjinohehin një herë e një kohë. Janë sipërmarrje në të gjitha drejtimet, me pasuri të pakufishme, që ndikojnë në ekonominë reale", ka deklaruar dje kryeprokurori i Antimafies dhe Antiterrorizmit italian, Federico Calfiero De Raho.

të gjerë përmes trafikut të kokainës, që mbërrin me tonelata nga Amerika Jugore dhe hyn në Itali përmes porteve të Livornos, Gioia Taura, Napoli e Salerno, por edhe përmes porteve të Adriatikut nga Shqipëria". Sipas kryeprokurorit të Antimafies, Ndrangheta ka shtrirë duart dhe në veri të Europës përmes një organizimi sipërmarrës, që vendos njerëzit e tyre në të gjitha pikat e referimit për biznesin e tyre. "Tregu i drogës - tha ai - përmes shoqërive 'offshore'



Vrasja e shqiptarit në Australi, arrestohet personi i katërt

Ditën e djeshme është arrestuar një person i katërt nga policia australiane për vrasjen e shqiptarit Urim Gjabri, 46 vjeç, ngjarje e ndodhur më 12 tetor në Australi. Sipas mediave vendëse, i arrestuari i katërt është një 31-vjeçar dhe pritet që të dalë para gjykatës ditën e nesërme. Më herët janë arrestuar edhe tre persona të tjerë si të përfshirë në vrasje. Nga hetimet e deritanishme rezultoi se shqiptari mund të jetë ekzekutuar për çështje që lidhen me drogën. Urim Gjabri u gjet i vdekur brenda shtëpisë së tij në zonën e Para Vista. 46-vjeçari jetonte me qira për rreth 6 muaj në atë banesë. Në shtëpinë e viktimës u gjetën disa bimë kanabisi të kultivuara. Lënda narkotike ishte vjedhur nga autorët e dyshuar pas i kishin ekzekutuar shqiptarin. Më pas u arratisën nga vendngjarja me makinën e viktimës, e cila u gjet e braktisur nga policia në një tjetër rrugë, në atë zonë. Policia dyshon se edhe viktima Urim Gjabri ka qenë pjesë e një grupi kriminal në Murrai Brigde.

NGJARJA

46-vjeçari jetonte me qira për rreth 6 muaj në atë banesë. Në shtëpinë e viktimës u gjetën disa bimë kanabisi të kultivuara. Lënda narkotike ishte vjedhur nga autorët e dyshuar pas i kishin ekzekutuar shqiptarin. Më pas u arratisën nga vendngjarja me makinën e viktimës, e cila u gjet e braktisur nga policia në një tjetër rrugë, në atë zonë. Policia dyshon se edhe viktima Urim Gjabri ka qenë pjesë e një grupi kriminal në Murrai Brigde.

investon në shoqëritë e lojërave të fatit, duke bërë qarkullimin e parave e kushtëzimin e tregjeve kudo qofshin. Faktikisht - ka deklaruar De Raho - gjendemi përballë një

borgjezie mafioze, që merret me shuma parash të pallogaritshme me profesionistë, kontabël e avokatë që shndërrohen në mendjen e tyre të rafinuar", ka thënë kreu i Antimafies.

Tirana International Airport
Nënë Tereza

TENDER NOTIFICATION

**FOR CONSTRUCTION WORKS FOR AIRFIELD 2020 SUB – PROJECT I
RECONSTRUCTION OF TAXIWAYS B, W AND W2
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT**

Tirana International Airport sh.p.k is requesting offers for reconstruction of TAXIWAYS B, W AND W2.

TIA is looking to contract a company to undertake this project that will consist of: demolition of existing pavement taxiway structures, soil removal and excavations, drainage works, full construction of taxiways, reconstruction of taxiways, airfield lighting and all required installation and connection works.

To participate in this process interested parties will need to retrieve the Invitation to Tender and Confidentiality Commitment Document together with the respective forms, which can be retrieved at Tirana International Airport premises, Administration Building, Rinas, until 23 of November 2018.

Only to the companies that will submit the confidentiality commitment and it's forms will be given the respective set of tender documents that contain the full information for submission of the offer.

The set of tender documents will be delivered free of charge, in a CD, upon receipt of the above forms.

Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked "CONSTRUCTION WORKS FOR AIRFIELD 2020 SUB – PROJECT I"

The address for submission of offers is:

Tirana International Airport sh.p.k
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs. on 20 December 2018.**

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:
ialimema@tirana-airport.com; fvojka@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com

Protesta në Greqi, në pranga 19 persona, mes tyre 1 shqiptar

Athina në shtetrrëhim të shtunën, policia sulmohet me molotov, gurë e lëndë plasëse

Pas protestave të së shtunës në mbrëmje pranë Universitetit Teknik Kombëtar të Athinës dhe Universitetit "Aristoteli" në Selanik, të cilat janë shoqëruar me dëmtime dyersh e dritësh, autoritetet greke kanë arrestuar 19 persona, mes tyre edhe një shqiptar, i identiteti i të cilit nuk bëhet me dije. "Trotauret dhe dritaret e shkatërruara, karriget e djegura dhe tabelat që u përdoren për të ngritur barrikada janë dëshmi e aktiviteteve të anarkistëve që zgjodhën të festonin në këtë mënyrë 45-vjetorin e një kryengritjeje studentore kundër regjimit ushtarak të atëhershëm të Greqisë", shkruan "Kathimerini". Mes të arrestuarve janë 15 grekë të moshës nga 17-37 vjeç. Të tjerët rezultojnë nga Shqipëria, Af-



ganistani, Rumania si dhe nga Palestina. Mediat greke, grupin e protestuesve e etiketojnë si anarkistë dhe vandalë, pasi veprimet e tyre ishin shkatërrimtare në dëm të pronës publike. Ndërkaq, Athina ka qenë nën shtetrrëhim të plotë gjatë natës. Episodet e rënda zgjatën 6 orë në qendër të kryeqytetit grek. Arrestimet filluan menjëherë pas demonstratës për 45-vjetorin e kryengritjes studentore të Politeknikut

kundër diktaturës greke të Juntas (Hunta). Pati një luftë me molotov, lëndë kimike, sulme me gurë e armë të ftohta në zonën e Politeknikut dhe Eksarhia në qendër të Athinës mes policisë greke dhe antiqeveritarëve e grupeve të tjera ekstremiste. Nga të dyja palët kishte të plagosur lehtë, madje janë kërcënuar edhe gazetarët. Të tjera episode ka pasur edhe në Selanik, në Iraklio, Kretë si dhe në qytete të tjera të vendit, më të kufizuara.

Ja e veçanta e rolit tim te "Dashuria s'mjafton", Drilon Hoxha më bënte të qeshja

Zaida Çobo:

Pas 'Big Brother', pres sukses si aktore, nuk kam pengje

Porosia për fëmijët: Duajeni veten pastaj të tjerët

Egla Xhemali

Stacionet e autobusëve, rrjetet sociale e madje edhe xhamat e taksive janë mbushur me posterin e filmit më të ri dhe më të komentuar të momentit "dashuria s'mjafton", i cili do të shfaqet brenda këtij muaji në ekranet e kinemave shqiptare. Shumë emra të njohur janë bërë pjesë e tij ku një ndër ta është edhe ish-konkurrentja e "BBA8" zaida çobo. Ajo u pikas në "BBA" për shpirtin sfidues e luftarak, ndjeshmërinë e një nëne, karakterin e fortë dhe guximin e të shprehurit të vërtetës. Zaida vjen më pranë publikut, tashmë si aktore. Pas daljes nga 'BBA' ajo nuk ju nda jetës publike dhe spektakleve. Në bashkëpunim me producentin nga kosova (dashnor asllani) dhe këikën (ish banor i 'BBA') zaida erdhi pranë publikut në rolin e producentes së spektakleve të ndryshme në shqipëri dhe jashtë saj, kosovë, serbi etj. Si: "Mis & mister internacional albania" etj. Zaida e vendosur që të jetë pjesë e ekranit si në rolin e opinionistes, komentueses, e ftuar në intervista të ndryshme, tregimit të eksperiencës së saj si në 'bb' ashtu edhe jetike, tashmë vjen krejtësisht ndryshe si aktore në rolin e një nëne që është gati të paguajë çdo çmim për frytin barkut të saj duke dashur kështu të bëjë publikun shqiptar të dashurohet me të dhe t'i japë mundësinë që të tregojë veten në fushën e re ku po tenton të jetë pjesë. Ky mund të konsiderohet si roli i saj i jetës sepse askush më mirë se një nënë nuk mund ta interpretojë atë me plot zell, devotshmëri, ndjeshmëri nënë ajo është e bindur që publiku do ta mbështesë fort dhe do t'i japë suport si gjithmonë. Kjo gjë mbetet për t'u parë pas shfaqjes së filmit.

U bëtë e njohur si pjesëmarrëse e 'Big Brother'. Pastaj daljet tuaja publike u shpeshuan. Tani ju sho-



him si aktore te filmi "dashuria s'mjafton". Si erdhi oferta për t'u bërë pjesë e tij?


Nuk është se më kanë munguar lidhjet e miqtë me

botën e artit, por 'big brother' pati efekt pozitiv dhe atraktiv ndaj personit tim. Oferta ishte si pjesë e miqësive të vjetra dhe të reja. Unë aty kam qenë gjith-

monë, por pas big brother-it u vunë në dukje aftësitë e mia për të aktruar.

Cila është e veçanta e personazhit tuaj?

Jam një nënë dhe si e



tillë, jam dhe në personazh. Veçoria e personazhit tim është pikërisht e të qenit nënë.

Sa e vështirë është të hysh në petkun e dikujt tjetër?

Për mua s'ka qenë e vështirë se siç e sipërpërmenda luaj rolin e një nëne.

Momenti që keni bërë më shumë dubla?

Kur kisha pjesën që duhet të qaja dhe sa herë që bëhesha gati regjisor drilon hoxha më bënte për të qeshur (është bukur të punosh me të).

Çfarë ka ndryshuar që prej rrugëtimit tuaj në 'big brother'?

E thashë dhe më parë as-

gjë. Doli në pah zaida dhe aftësitë e saj.

Porosia që u jepni më shpesh fëmijëve?

Veç një porosi kam për ta: Duajeni veten pastaj të tjerët.

Pengu më i madh që keni?

Peng! (Qesh) unë s'kam pengje. Kam tre fëmijë si yje, falënderoj zotin për çdo gjë që më ka dhuruar.

Çfarë do të thotë "ta marrësh jetën siç të vjen"?

Të bëhesh nënë babë për tre fëmijë, e ndërkohë rëndësi ka të përpiqesh që atyre mos t'i mungojë asgjë. Çdo sakrificë që kam bërë e kam bërë për vete dhe fëmijët e mi.



Agon Amiga sulmon Getoarin, paralajmërohet ndarja e BABASTARS

Dy reperët e njohur të grupit BABASTARS duket se do i japin fund bashkëpunimit të tyre disavjeçar. Agon Amiga sapo ka publikuar këngën "Oh bir", e cila deri më tani ka rezultuar një sukses i vërtetë. Amiga ka zbuluar vet se kjo këngë ka qenë diss ndaj kryetarit të grupit Getoarit. Pjesa në këngë, ku Agoni flet kundër reperit tjetër është kjo: "Të kam mësuar çfarë të veshësh, të kam mësuar çfarë të blesh, sot mbas 15 viteve jeni duke ma punuar". Kështu është konfirmuar në një farë mënyre ndarja përfundimtare e grupit.



Dafina Zeqiri çmendi fansat me twerk dhe fustanin e shkurtër

Këngëtarja e dashur për publikun Dafina Zeqiri nuk di të ndalet. Ajo numëron një sërë hitesh në repertorin e saj, si dhe ka arritur të ketë një milion ndjekës në rrjetin social "Instagram". Ajo dallohet për energjinë e saj dhe performancat e jashtëzakonshme në koncerte. Së fundmi, bukuroshja e ka djegur vendin ku ishte e ftuar për të performuar. E veshur me një fustan shumë të shkurtër, Zeqiri ka krijuar një atmosferë të jashtëzakonshme. Në disa momente asaj i është ngritur lart fustani. Këngëtarja ka tentuar disa herë që ta ulë atë për të mos i vendosur fansat në siklet. "Uppssss" ka qenë mbishkrimi që ka shoqëruar videon e postuar nga vetë ajo, megjithatë duket se këngëtarja e ka shijuar atë moment.





Luana Vjollca flet për lumturinë e saj më të madhe, zbulojeni për çfarë bëhet fjalë

Luana Vjollca është një nga moderatorët më të dashur për publikun shqiptar. Kjo vihet re dhe në rrjetet sociale, ku miliona fansa e ndjekin hap pas hapi atë. Vjollca ka publikuar së fundmi në "Instagram" një foto e veshur me sportive, ku tregon dhe se është mjaft e lumtur. "Unë më e lumtura nga komentet tuaja mbrëmë", duke u referuar gjithë fjalëve të fansave për emisionin "Shiko kush luan". Duket se bukuroshja po pëlqehet çdo ditë e më shumë nga puntatat e emisionit të saj që natyrisht ka rezultuar një sukses i vërtetë që vjet.



Adelina Tahiri tregon ndërhyrjet plastike, ja pse është pënduar bukuroshja

Që kur është bërë nënë ajo ka vendosur të mos mbajë më të fshehtat me ndjekësit e saj. Edhe këtë herë nëpërmjet një video live në rrjetin social "Instagram" Adelina Tahiri ka treguar të vërtetat mbi pyetjet e fansave. Ndër të tjera bukuroshja ka pranuar dhe ndërhyrjen plastike që ka bërë duke pohuar se tanimë është pënduar. "Nuk kam bërë operacione plastike. Kam ndërhyrë të buzët, por nuk është operacion. Megjithatë jam pënduar sepse po më akuzoni se jam bërë e gjitha"-shprehet këngëtarja. Kujtojmë se Tahiri është akuzuar mjaft herë nga ndjekësit për operacione plastike.



INTERVISTA ME STUDIUESËN

"Telefonata Kadare-Enver Hoxha dhe raporti i shkrimtarit me diktatorin"

Fatmira Nikolli

Libri "Kur grinden sunduesit" na risjell Kadarenë, një student i ri nga Shqipëria, një vend ku komunizmi ishte duke përgatitur hartuesit shpirtërorë të filozofisë së tij, në zemrën e një kryeqyteti të madh stalinist me kureshtjen dhe aftësinë për ta kuptuar drejt një sistem. Moskë, Pastërnak dhe gjithë ajo histori e ndërlikuar raportesh njerëzore e politike mes shkrimtarëve dhe Stalinin apo Hrushovit më vonë do ta bënin shkrimtarin e ri shqiptar të mësonte distancën e duhur nga ku duhet ta shihte diktaturën më pas e si duhet ta fitonte betejën me të.

Alda Bardhyli prej kohësh ka nisur të studiojë veprën dhe jetën e Ismail Kadaresë. Drejtore e Qendrës së Studimeve Shqipe "Kadare" pranë Institutit Europian "Pashko", ajo vjen më poshtë në një bisedë mbi leximin ndryshe të librit më të ri të shkrimtarit "Kur sunduesit grinden" Botimet "Onufri".

Zbulon mes të tjerash një telefonatë mes Kadaresë dhe Hoxhës dhe presionin që fshihej pas saj. Për Bardhylin, nëse telefonata e Stalinin ishte t'i kërkonte mendim Pastërnakut rreth Maldeshtimit, në rastin e shkrimtarit shqiptar, telefonata është po kështu e papritur dhe diktatori Hoxha nuk i kërkon asgjë, thjesht e uron për një poemë të botuar në gazetën "Drita". Veçse, nëse shohim kontekstin e kohës kur Enver Hoxha i telefonon Kadaresë, kjo telefonatë më shumë se një mbështetje ndaj shkrimtarit të ri, ishte një kërkesë. Në këtë kontekst telefonata e Hoxhës ishte një lloj paralajmërimi për shkrimtarin e ri që jo vetëm se ishte nën lupën e Partisë, por kjo e fundit kërkonte "ndreqjen e gabimeve" të deritanishme, ndryshe do ta ndëshkonte. Pas kësaj telefonate, qëndrimi i Hoxhës ndaj Kadaresë do të ashpërsohej.

"Kur grinden sunduesit" është libri më i ri i Ismail Kadaresë, i cili u prezantua gjatë ditëve të Panairit të 21 të Librit. A është ky një libër për diktatorat?

Botimin e librit "Kur grinden sunduesit" nga Kadare vetëm pak ditë më parë do të quaja një ngjarje jo vetëm për kulturën shqiptare, por edhe për atë botërore. Gati 84 vjet nga ngjarja, që për gati një shekull vazhdon të ketë interpretime të ndryshme në botën letëre, duke ndarë shpeshherë kritikë e letërsisë dhe autorët në qëndrime. Kadare i rikthehet telefonatës së famshme mes shkrimtarit të njohur rus Boris Pastërnak dhe Stalinin në vitin 1934. Rikthimi në këtë telefonatë, që duket se do sjellë gjithnjë "zhurmë" mbi qëndrimet dhe rolin që shkrimtarët dhe intelektualët patën në raport me diktaturat, Kadare e çon mendimin dhe studimet shqiptare në një niv-



Ismail Kadare

Alda Bardhyli: Si u njoh Kadare me Pastërnakun dhe çfarë mësoi nga raporti i tij me Stalinin

el tepër bashkëkohor. Leximi i këtij libri do të jetë një joshje e përhershme, një udhëtim në honet e errëta e shpesh tunduese të salloneve letrare ruse, takime me dashnore të dëshpëruara dhe botë sekretesh, që për vite me radhë gumëzhijnë nga rrëfime, që në thelb kanë qëndresën e një kaste të jashtëzakonshme shkrimtarësh, që u përballën me komunizmin. Janë trembëdhjetë versione të kësaj telefonate të famshme, të cilat vijnë në një humlumtim nga Kadare, për të ndërtuar në 174 faqet e këtij libri, historinë e jashtëzakonshme dhe të përhershme që ta jep vetëm letërsia edhe kur ajo është përballë tiranive më të mëdha.

Libri është dhe një "rikthim" i shkrimtarit në Moskën që e vizitoi për herë të parë në vitin 1958. Që kur zbuloi letërsinë, që kur ishte ende gjimnazist në Gjirokastrë, Kadare ëndërronte Institutin "Gorki". Ëndrra për letërsinë lidhej me këtë institut nga ku kishin dalë shkrimtarë të mëdhenj rusë. Këtë e tregon dhe fakti që kërkesa e tij për studime pas mbarimit të gjimnazit ishte ky institut. Fillimisht, kjo kërkesë do t'i refuzohej e në vend të tij do t'i shkojë shkrimtari Qamil Buxheli dhe vetëm një vit më vonë Liri Belishova, e cila ishte sekretare e Komitetit Qendror të PPSH-së do të firmosë dokumentin me nr. protokoll 332, kërkesën e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, propozimin për të dërguar në kursin 1-vjeçar të letërsisë pranë Institutit "Gorki", në bazë të konventës për bashkëpunim kulturor-shkencor me Bashkimin Sovjetik shokun Ismail Kadare... Bashkë me Kadarenë, atë vit udhëtoi drejt Moskës si student dhe Sterjo Spasse, autor i romanit "Pse", i cili shihej si shkrimtar dekadent, e kjo vajtje e tij në Moskë

do ta tërhiqte menjëherë vëmendjen e autorit shqiptar, që kur në një nga dhomat e konviktit gjeti dorëshkrimin e "Doktor Zhivagos". Më pas, protestat studentore kundër tij, të cilat Kadare do t'i shihte nga afër do ta bënin Pastërnak një figurë, që në një mënyrë a një tjetër do të ndikonte në konfigurimin e një vizioni jo vetëm mes tij dhe letërsisë, por edhe mes tij dhe diktaturës. Libri "Kur grinden sunduesit" na risjell Kadarenë, një student i ri nga Shqipëria, një vend ku komunizmi ishte duke përgatitur hartuesit shpirtërorë të filozofisë së tij, në zemrën e një kryeqyteti të madh stalinist me kureshtjen dhe aftësinë për ta kuptuar drejt një sistem.

Moskë, Pastërnak dhe gjithë ajo histori e ndërlikuar raportesh njerëzore e politike mes shkrimtarëve dhe Stalinin apo Hrushovit më vonë do ta bënin shkrimtarin e ri shqiptar të mësonte distancën e duhur nga ku duhet ta shihte diktaturën më pas e si duhet ta fitonte betejën me të. Nga ana tjetër, Moskë është edhe një periudhë e bukur, e pahar-

mes kësaj telefonate me telefonatën mes Stalinin dhe Pastërnak?

Në të gjithë historinë e vendeve komuniste përplasjet mes tiranëve dhe shkrimtarëve e poetëve kanë qenë ndoshta nga më të fortat. Stalini, por edhe diktatorë të tjerë e kuptuan herët se arti nuk duhet të ishte gjë tjetër veçse një instrument për të forcur doktrinën e tyre. Historia e letërsisë ruse, por dhe ajo e vendeve të tjera që përjetuan komunizmin është e mbushur me burgime shkrimtarësh, internime, ndalime botimesh, arratisje... Në asnjë fushë tjetër diktatura nuk e ka ndërur më shumë rezistencës sesa ndaj letërsisë. Letërsia duhet thënë se ka qenë një ndër fushat ku rezistenca ka qenë më e fortë. Rasti i letërsisë shqipe e tregon këtë, ashtu si e gjithë proza e Kadaresë. E ky libër i Kadaresë, ashtu si gjithë letërsia e tij, është një mënyrë për të parë sesi letërsia arrin ta mposhtë sistemin. Të dy këto telefonata e tregojnë këtë. Në të dyja rastet janë tiranët, ata që telefonojnë shkrimtarët. Distanca në kohë e dy telefonatave është rreth 3 dekada. Nëse telefonata e Stalinin ishte t'i kërkonte mendim Pastërnakut rreth Maldeshtimit, në rastin e shkrimtarit shqiptar telefonata është po kështu e papritur dhe diktatori Hoxha nuk i kërkon asgjë, thjesht e uron për një poemë të botuar në gazetën "Drita". Nëse shohim kontekstin e kohës kur Enver Hoxha i telefonon Kadaresë, kjo telefonatë më shumë se një mbështetje ndaj shkrimtarit të ri ishte një kërkesë. Kadare e kishte shprehur hapur një lloj pasigurie për sa i përket realizimit socialist si tek "Qyteti pa Reklama" apo tregimi "Nudoja", botuar në atë periudhë. Pas ardhjes nga Moskë, ai kishte shfaqur hapur një lloj modernizmi në shkrimet e tij. Skepticizmi ndaj tij kishte nisur të shfaqej në vitet '60-të kur po dominonte gjithnjë e më tepër në botimet e tij tema e largimit nga atdheu. Në tregimin e shkurtyr të 1960-ës, "Në skaj të aeroportit", që zhvillohet në Moskë, dy të rinj të dëshuruar bisedojnë me njëri-tjetrin ndërsa avionët tupolevë rusë e karavelat franceze shkojnë e vijnë. Shkrimtari i ri së shpejti do të largohet nga Moskë. Por për ku? Në Perëndim apo në Lindje? Në arratisje, apo të kthehej në atdhe? Në këtë kontekst, telefonata e Hoxhës ishte një lloj paralajmërimi për shkrimtarin e ri, që jo vetëm se ishte nën lupën e Partisë, por kjo e fundit kërkonte "ndreqjen e gabimeve" të deritanishme, ndryshe do ta ndëshkonte. Pas kësaj telefonate, qëndrimi i Hoxhës ndaj Kadaresë do të ashpërsohej nëse shohim dokumentet e kohës, kritikë e vazhdueshme në mbledhjet e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, sidomos më vonë pas botimit të veprës së tij në Perëndim, ku gjendja e



Alda Bardhyli

shihet si një ndërrim kursi, që tashmë Shqipëria do shkojë drejt Perëndimit...

Cila ishte Moskë që gjeti Kadare dhe lidhja e tij me Pastërnak?

Kadare do të mbërrinte në Moskë në vitin 1958-të, pikërisht në vitin kur Boris Pastërnak u vlerësua me çmimin Nobel, periudhë e zbutjes hrushoviane. Një vit më parë, më 1957, romani i tij "Doktor Zhivago" u botua nga Feltrinelli në Itali. Atë, Kadare ende i ri, 22 vjeç, do të shihte më nga afër orkestrimin që komunizmi i bënte kulturës. Raportet e shkrimtarëve rusë me komunizmin dhe mënyrën sesi ky i fundit dirigjonte sistemin do ta ndihmonin Kadarenë të kuptonte laboratorin e një raporti jo të lehtë, të cilin do t'i duhej ta administronte më vonë mes tij dhe regjimit të Enver Hoxhës.

Boris Pastërnak, që në atë kohë ishte 68 vjeç, i arratisur nga Rusia

rueshme në jetën e Kadaresë për vetë atmosferën e lirë që ai gjeti atje. Jo vetëm në kontekstin njerëzor, raporte të lira dashurie, por edhe të leximeve bashkëkohore të ndaluar në Shqipëri. Ai pati mundësinë të lexonte letërsi bashkëkohore perëndimore, si veprat e Sartre, Camus dhe Hemingway, të cilat kishin filluar të përktheheshin në rusisht. I influencuar nga modernizmi rus dhe europian, ai eksperimentoi me gjuhën dhe u kritikua për shkrim poezish të mbushura me dekadencë e formalizëm borgjez. Duke u shoqëruar me të emigruar, me funksionarë të dënuar, intelektualë që po riedukoheshin dhe duke vëzhguar lidhjet e ngatërruara të politikës me letërsinë në shtetin socialist, Kadareja i ri filloi të nxirrte konkluzionet e tij.

Në libër flitet për një telefonatë mes Enver Hoxhës dhe Ismail Kadaresë. A ka ngjashmëri

shkrimtarit do të ishte gjithnjë e më shumë në rrezik. Janë një sërë reagimesh që po e çojnë Kadarenë në këto vite drejt një dileme të madhe, që kishte të bënte me dizimin e tij në duhet apo jo të vazhonte shkrimin e letërsisë, për ta çuar drejt vendimit që do ta vendoste atë në sprovën më të madhe të një shkrimtari brenda kampit socialist, shkrimin e romanit "Dimri i vetmisë së madhe".

- Të ndërtohet një libër mbi tri minuta telefonatë, duket grishëse?

E gjithë mjegulla e vërtetësisë së telefonatës mes Stalinit me Pastërnakut mbart në vetvete shumë pyetje jo vetëm mbi raportin e Pastërnak, një shkrimtar i kontestuar në vendin e tij dhe i vlerësuar në Perëndim pikërisht në kulmin e komunizmit rus, por dhe sa mundi të deprimonte diktatura aleancën mes shkrimtarëve. Nëse ka një pyetje e cila vijon të studiohet dhe t'i jepet përgjigje në forma të ndryshme nga kritikë të njohur ende sot është në e mbrojtja Pastërnaku, Mandelstamin. Ky i fundit ishte i arrestuar... Dhe a e la Pastërnaku atë në baltë? Ka shumë interpretime të mënyrës se si Pastërnaku iu përgjigje pyetjes së asaj telefonate të papritur se ç'mendonte për Mandelshamin... Përtej përgjigjes së Pastërnakut, përgjigja që bota letrare ruse kërkon ta nxjerrë në pah për të vënë në vend qëndresën e saj është moskëundja e Pastërnakut përballë presionit për të mbrojtur një poet, që ndoshta nuk ishte miku i tij, por në të njëjtën kohë ishte bashkë me të në qëndresën

kundër revolucionit. Në fakt, një nga debatet që edhe studimet e sotme shqipe bëjnë përsa i përket raportet të letërsisë me diktaturën është se sa mundën t'i mbijetonin përçarjes brenda kampit letrar vetë shkrimtarët. Në Shqipëri diktatura arriti ta kthente Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve në një qendër ku kontrollohej i gjithë laboratorit krijues, duke i bërë një pjesë të shkrimtarëve të spiunonin njëri-tjetrin. Janë trishtuese dokumentet që tregojnë sesi u transformuan një pjesë e tyre. Kjo e bën këtë telefonatë historike pikërisht në rolin e saj për të konfirmuar qëndresën dhe aleancën mes artit ndaj diktaturës.

- Lasgush Poradeci është një personazh që Kadare i rikthehet sërisht në këtë libër?

Në historinë e eseistikës sonë letrare, një nga kontributet më të bukura të Kadaresë është ai i rikrijimit të figurës së Lasgush Poradecit. Me aftësinë e shkrimit, Kadare i ka dhënë Poradecit jetën e vërtetë, veshur me aureolën magjike të figurës së poetit, që e bën atë sa tërheqës apo edhe të pakuptuar në të njëjtën kohë, duke e zgjuar nga gjumi i madh i harrës komuniste. Në një histori letrare, ku kanë munguar biografitë e shkrimtarëve "Ika e shtërgut të fundit", një libër kushtuar figurës së Lasgush Poradecit shkrues nga Kadare kohë më parë është një ndër modelet e shkrimit, ku letërsia kërkon të ndërtojë jetën e mōhar të një poeti në mënyrën më të bukur.

"MARUBI" RIKTHEHET NË ITALI

Kultura si pasaportë sjell Shqipërinë në qendër të vëmendjes", njofton Ministria e Kulturës, teksa bën me dije se ministria Mirela Kumbari, me Presidentin e Trienales, Stefano Boeri dhe ambasadorin e Shqipërisë në Itali, Anila Bitri, shënuan një ngjarje të rëndësishme në Vitin të Skënderbeut, pjesë e programit të Ministria e Kulturës për vitin 2018. Ajo e cilëson një punë fantastike të stafit të Muzeut Kombëtar të Fotografisë "Marubi", kuruar mjeshtërisht nga Zef Paci, ku sillen 100 vjet nga historia e Shqipërisë, përmes portretëve që kalojnë para kamerës së Marubit e më pas të fotografëve të tjerë, të cilët fiksojnë momente kyç të jetës njerëzore shqiptare.

"Një ritual elegant oksidental të kuruar deri në detaje, që alternonte portretet me veshje tradicionale, me vështrime beshuese, sidomos femërore që nga ezmerja deri te turqeshja, nga lypsarja deri te madama, duke e kthyer çdo portret në një arketip. Në margjina të arteve të tjera, fotografia e Marubit, Idromenos, Kodhelit, Shan Picit, Nenshatit e me radhë ishin pasqyra më fantastike, njëherësh moderne për kohën e vendin por edhe, po aq klasike, e atij kufiri të hollë Lindje-Perëndim", shkruan Kumbaro në profilin e saj në "Facebook". Sipas ministres, dallimi i madh i fotografëve



shqiptarë prej atyre tipikë orientalistë të kohës ishte pikërisht hapësira e dallueshme që e vendoste estetikën teatrale të kompozit të shërbim të një frymë kombëtare shqiptarizuese aq të domosdoshme për epokën. "Sepse ata ishin artistë të jashtëzakonshëm dhe atdhedashës shembullorë. La Triennale di Milano është një ndër skenat e duhura, që ky ritual tashmë i shekullit të kaluar të jetë një pasaportë autentike shqiptare që flet për bashkëkohësi kulturore", thotë Kumbaro. Mes të përditshmes dhe ritualit, imazhet e ekspozitës "L'archivio Marubi. Il rituale fotografico" (Arkivi Marubi. Ritualit fotografik) e kuruar nga Zef Paci, ruajnë kujtesën e mbi një shekulli jetë. Bëhet fjalë për trashëgiminë fotografike të Muzeut Marubi në Shkodër, i pari muze fotografie i cili në datat 16 nëntor deri më 9 dhjetor 2018, paraqet në Triennale di Milano, ekspozitën e tij të parë në bashkëpunim me La Triennale dhe Museo di Fotografia Contemporanea. Për këtë ekspozitë janë përzgjedhur rreth 170 fotografi prej autorëve më të njohur të kole-

ksionit. Imazhet që do të shfaqen janë shkëputur prej vazhdës së formuar nga fotografatë, të tyre prej shkrepeve të tyre e të shkëputura prej vetë vazhdës së jetës. Bashkësia e këtyre gjurmëve dhe fragmenteve të jetës të shkëputura nga fluksi i përditshmerisë ndërton një narracion përmes fotografisë, në rrugëtim përmes vendeve, fytyrave, marrëdhënieve njerëzore që hetojnë ritet e kalimit që në shekuj u fiksuat nga rituali fotografik. Fotografia si ritual na ka lejuar të gjurmohim komunitetin e historitë e tij të shumta me dëshirat për t'i dhënë publikut shijen e një realiteti shumëformësh e eklektik. Kjo ekspozitë organizohet nga Muzeu Marubi në La Triennale di Milano në kuadër të kalendarit të "Vitet Mbarëkombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu", me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës së Shqipërisë, në bashkëpunim me Museo di Fotografia Contemporanea dhe Ambasadën e Shqipërisë në Itali.

YMERI: TË ULET TVSH-JA E LIBRIT, MË E LARTA NË BE

Ulja e TVSH-së për librin nga 20% në 6% si edhe ajo e taksës për krijimtarinë kanë qenë këto dy kërkesat kryesore të Shoqatës së Botuesve Shqiptarë në komisionin e Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik gjatë diskutimit të buxhetit. Për kreun e shoqatës, Petrit Ymeri, Shqipëria ka taksë më të lartë të librit krahasuar me vendet e BE dhe qeveria duhet të ndërhyjë për uljen e saj, gjë e cila do të reflektë, sipas Ymerit, në uljen e çmimit të librave, por edhe në rritjen e cilësisë së tyre. Krijimtaria në vendin tonë aktualisht taksohet me 15%, shifër e cila është cilësuar e padrejtë dhe mjaftë e lartë nga kreu i shoqatës. Ymeri kërkon më shumë investime për bibliotekat në vend, të cilat prej vitesh nuk janë të pasuruara me libra.




në blerje, e pangjarë në asnjë vend evropian dhe zero për qind në shitje. Ky tatum nuk rimbursohet, siç është logjika e këtij tatum. Kërkojmë një TVSH të ulët 5% në blerje dhe shitje. Kërkojmë të ulet tatum mbi të

ardhurat për veprimtarinë krijuese nga 15% në 5%", deklaronte në nëntor të vitit që shkoi Petrit Ymeri. Në përgjigje, ministria Mirela Kumbaro, shprehej se: "Ju siguroj që nëse ne nxisim leximin si aktivitet emancipimi, si aktivitet edukimi, zgjidhim njëkohësisht edhe shumë probleme të tjera: bashkëpunim radhët tona. Edhe unë nuk jam dakord për 15% mbi krijimtarinë. Sigurisht nuk do të fitohen të gjitha përmjerë, por është një argument që unë nuk do të rresht ndonjëherë së harxhuari energjitë e mia dhe mjetet qeveritare".

PERSEKUTIMI KOMUNIST I MID'HAT FRASHËRIT, PUBLIKOHEN 'ONLINE' DOKUMENTET E PËRNDJEKJES

Kthimi në atdhe e eshtrave të Mit'hat Frashërit ka hapur një debat publik mbi rolin e tij, para, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Mes etiketimit si dijetar, atdhetar apo kolaboracionist, qëndrojnë qindra faqe dokumentesh. Dje, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit ka publikuar në faqen zyrtare listën e dokumenteve arkivore të përndjekjes së Sigurimit ndaj Mid'hat Frashërit. Materialet janë disa qindra faqe dhe vihen në dispozicion të të interesuarve, studiuës dhe kërkues shkencorë, ish-të përndjekur dhe familjarë të tyre, shoqëri civile dhe media, duke mundësuar njohjen me inventarët e plotë dhe më gjerë.



Jugosllavisë para lufte e që ndiqeshin nga autoritetet italiane dhe lista emërore e personelit italian në Shqipëri deri më 1943, skica e vendndodhjes.

Konkretisht, janë identifikuar: -Viti 1945, Dosje - fashikull me dokumente mbi veprimtarinë tradhtarë të kriminelit të luftës Mid'hat Frashëri gjatë okupacionit në arrati. -Viti 1945, Dosje - fashikull me dokumente të kriminelit të luftës Mid'hat Frashëri mbi veprimtarinë e tij armiqësore dhe antikombëtare gjatë regjimit të Zogut. -Viti 1945, informacione mbi veprimtarinë e Ballit Kombëtar, promemorie mbi formimin e disa qeverive gjatë luftës, lista e informatorëve në shërbim të

mbëtar në mërgim. -Viti 1950, historiku i organizatës së Ballit Kombëtar dhe veprimtaria e saj në Shqipëri dhe në mërgim. Thirrjet e kongresit të kësaj organizate dhe polemika mbi organizatat e tjera të emigracionit reaksionar shqiptar në perëndim.

Të gjitha dokumentet vihen në dispozicion të të interesuarve, studiuësve, medias, mbi bazë kërkese dhe konform ligjit në fuqi.

Duke i vënë në dispozicion të publikut këto materiale, AIDSSH njofton se krijon mundësi për njohje të thelluar me dokumentet, procesverbale, dosje e statistika të periudhës së marrë në shqyrtim, mbi rezistencën dhe përndjekjen, për të hedhur dritë mbi të shkuarën me baza profesionale dhe transparencë, në komunikim të hapur me publikun.

Autoriteti për Informim mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit është përgjegjës për zbatimin e ligjit, lidhur me mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe informimin në lidhje me to, bazuar në ligjin nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit dhe Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

"Destabilizimi i vendit, mënyra e Rusisë për t'u marrë me SHBA"

Eksperti amerikan: Ndarja e Kosovës, pjesë e planit të Putinit

Phillips: Ndarja mund të nxisë konfliktin etnik

Eksperti amerikan i politikës së jashtme, David Phillips, gjatë një interviste për gazetën "Zëri" ka theksuar se presidenti rus e sheh Kosovën si një projekt amerikan dhe destabilizimi i vendit është mënyra e Putinit për t'u marrë përsëri me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për ndërhyrjen e NATO-s. Sipas tij, ndarja është pjesë e planit strategjik të Putinit për të minuar ndikimin perëndimor në Kosovë dhe për të zgjeruar ndikimin e egër të shtetit të tij duke e forcuar Serbinë, shkruan Gazeta "Zëri". Presidentët Hashim Thaçi dhe Vladimir Putin u pajtuan shumë mirë gjatë takimit që zhvilluan në Paris, por ne nuk duhet të mashtrohemi, sepse Rusia nuk është mike e Kosovës e as e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kështu ka theksuar gjatë një interviste për gazetën "Zëri" David Phillips, ekspert amerikan i politikës së jashtme. Ish-këshilltari i lartë në Departamentin Amerikan të Shtetit vlerëson se presidenti rus e sheh Kosovën si një projekt amerikan dhe destabilizimi i vendit është mënyra e Putinit për t'u marrë përsëri me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për ndërhyrjen e NATO-s, për koordinimin e njohjes ndërkombëtare të shtetit më të ri në Evropë dhe për marginalizimin e Rusisë në skenën botërore. Sipas tij, ndarja është pjesë e planit strategjik të Putinit për të minuar ndikimin perëndimor në Kosovë dhe për të zgjeruar ndikimin e egër të Rusisë, duke e forcuar Serbinë. "A do të garantojë Putin që Rusia do të



Eksperti amerikan i politikës së jashtme, David Phillips

heqë veton e saj në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për anëtarësimin e Kosovës? A mund ta bindë Kinën? Unë jam skeptik", thotë mes tjerash Phillips. Eksperti amerikan i politikës së jashtme gjatë kësaj interviste për "Zërin" po ashtu ka bërë të ditur se kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj për çështjen e kufijve në shtator të këtij viti i ka shkruar letër këshilltarit të sigurisë kombëtare në SHBA, John Bolton, përderisa nga një kopje të kësaj letre u është dërguar sekretarit amerikan të Shtetit Mike Pompeo

dhe sekretarit të Mbrojtjes James Mattis. "Letra e Haradinajt i komunikoi pikëpamjet e tij mbi përpjekjet e rrezikshme dhe destruktive nga disa elementë të Kosovës dhe të Serbisë për të hyrë në një lloj shkëmbim territori. Aq sa di unë, Bolton nuk u përgjigj në këtë letër. Për më tepër, SHBA-ja nuk ka arritur të shprehë qartë qëndrimin e saj mbi ndarjen. Ndarja mund të nxiste një fazë të re të konfliktit etnik në Kosovë dhe në rajon, duke destabilizuar shtetet e brishta multietnike", ka potencuar Phillips. Ai ka folur edhe

Kosova bllokoi importin e produkteve të vendeve që s'e njohin si shtet

Endrit Shala, ministri i Tregtisë dhe Industrisë, ka lëshuar tjetër urdhëresë në vazhden e zbatimit të politikave që fuqizojnë Republikën e Kosovës. Pas raportimeve të qytetarëve dhe vërtetimit të gjendjes nga ana e Inspektoratit të Tregut që kanë hasur në disa mallra që importohen në Kosovë me mbishkrimin "Kosovë/o dhe Metohi", "Kosovë/o UNMIK" apo "Kosovo/a Rezoluta 1244", ministri ka urdhëruar të ndalohet hyrja e këtyre produkteve në territorin e Kosovës, shkruan KP. Pas konstatimit në terren, ministri Shala ka lëshuar një urdhëresë



për Inspektoratin e Tregut ku ka kërkuar që të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që menjëherë t'i largojnë nga tregu produktet me etiketime të tilla, apo çdo emërtim tjetër në kundërshtim me emërtimin zyrtar të Republikës së Kosovës.

për vizitën e fundit në Serbi dhe në Kosovë të zëvendësndihmës sekretarit amerikan të Shtetit Matthew A. Palmer, vizitë, sipas tij, më shumë krijoi konfuzion sesa qartësi. "Palmer gjatë kësaj vizite shfuqizoi rolin udhëheqës të Amerikës. Ai këmbënguli se SHBA-ja nuk ishte 'një palë negociuese' për detajet e normalizimit në mes të Serbisë dhe të Kosovës". "Normalizimi është kritik

Megjithatë, një marrëveshje e keqe është më e dëmshme sesa asnjë marrëveshje. Dialogu duhet të përfundojë kur Kosova t'i arrijë objektivat e saj kryesore, duke përfshirë garancitë nga SHBA-ja dhe bashkësia ndërkombëtare. Sovraniteti i Kosovës dhe integriteti territorial janë vendime të rëndësishme. Negociatat nuk duhet të nxitin ose të kryhen në fshehtësi prapa dervet të mbyllura."

SHKURT

Putin siguron: Rusia s'ka ndërhyrë në zgjedhjet amerikane

Presidenti rus, Vladimir Putin siguroi zëvendës-presidentin e SHBA-së, Mike Pence gjatë një takimi në Singapor se Rusia nuk ka ndërhyrë në zgjedhjet amerikane të 2016, konfirmoi Kremli. Javën e kaluar, Vladimir Putin dhe Mike Pence zhvilluan një takim të shkurtër joformal që zgjati jo më shumë se 10 minuta në kuadër të samitit të Shogatës së Vendeve të Azisë Juglindore (ASEAN) në Singapor, shkruan ATSH. "Amerikanët po flasin gjatë gjithë kohës rreth ndërhyrjeve në zgjedhje. Pence, sigurisht nisi diskutimin me Putin për këtë çështje", pohoi zëdhënësi i Kremliut, Dmitri Peskov gjatë një emisioni të transmetuar të dielën në mbrëmje në televizionin rus.

Meksikë, vdes në burg lordi meksikan i drogës

Lordi meksikan i drogës, Hector Beltrán Leyva ka vdekur pas një sulmi në zemër në burg të Meksikës. 56-vjeçari u transferua nga burgu në një spital, por nuk arriti të shpëtonte, thanë zyrtarët e qeverisë. Ai ishte një nga katër vëllezërit që udhëhoqën kartelin e drogës me të njëjtin emër, i cili ishte i njohur për rivalitetin vdekjeprurës me kartelin Sinaloa të udhëhequr nga Joaquín "El Chapo" Guzmán. Leyva, i fundit i vëllezërve që kryesoi kartelin, u arrestua në tetor 2014. Zyrtarët e burgeve thanë se transferuan Beltrán Leyva nga një burg me siguri maksimale, ku vuante dënimin, në një spital në qytetin e afërt të Toluca's sapo vumë re se ai po vuante nga dhimbjet në gjok. Ai po përballlej me akuzat për trafikim të marijuanës, heroinës, kokainës dhe metamfetaminës. Hectorsi mori drejtimin e kartelit Beltrán Leyva pasi vëllai i tij Arturo u vra gjatë një shkëmbimi zjarri me policinë meksikane në 2009.

"THE GUARDIAN" KA NISUR TË PËRDORË EMRIN MAqedonia E VERIUT

Edhe pse emri nuk është zyrtarizuar në Kuvend, gazeta britanike "The Guardian" ka filluar të përdorë dhe shkruajë emrin Maqedonia e Veriut. Gazeta ka publikuar një shkrim lidhur me 50 vërrat më të mira në prag të festave të fundvitit, mes të cilave përmendet edhe "Krashotija" e kompanisë së verërave "Tikvesh".

FOTOLAJM

Haradinaj viziton Vjenën, kërkon liberalizimin e vizave

Kryeministri i Kosovës: Kemi përmbushur kriteret, lëvizja e lirë të futet në axhendën e BE

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj u ndodh në një vizitë zyrtare në Austri, ndërkohë që gjatë takimit me kancelarin Sebastian Kurz ka kërkuar që liberalizimi i vizave të futet në axhendën e Bashkimit Evropian. "Në Vjenë të Austrisë zhvilluam një mëngjes pune me kancelarin Sebastian Kurz dhe liderët e vendeve të Ballkanit Perëndimor, ku theksova se Kosova është e përkushtuar në fuqizimin e bashkëpunimit rajonal dhe gatshme të marrë përsipër obligimet e saja, por se kjo duhet të jetë reciproke. I njoftova homologët se vendi ka shënuar progres në implementimin e MSA-së dhe ERA 1 dhe se tani po presim edhe lançimin e ERA 2. Kosova është vendi i vetëm në BE dhe rajon që ende nuk lëviz lirshëm dhe nga Kan-

celari Kurz kërkoja që liberalizimi i vizave të futet në axhendën e BE-së, sepse Kosova ka përmbushur të gjitha kriteret e vëna nga BE. Përveç të drejtës tonë për lëvizje të lirë, liberalizimi i vizave për Kosovën do të thotë më shumë partneritet, më shumë treg e mundësi këmbimi për vendet e BE-së dhe rajonit", shkruan Haradinaj në Facebook'.

Ministria e Financave publikon emrat e personave që marrin kështin e tretë të dëmshpërblimit

5.700 të përndjekurit që marrin kompensimin

Tabela me çdo dokument që mungon në secilën dosje të trashëgimtarëve

Rreth 5.700 trashëgimtarë të ish-dënuarve politikë që presin të marrin kështin e tretë duhet të plotësojnë dokumentacionin që u mungon në dosje për të marrë më pas paratë. Lista është bërë publike dhe nga Ministria e Financave. Bëhet fjalë për përfitues të kategorisë jo parësore që do të trajtohen me dëmshpërbllim, por që sipas këtij dikasteri duhet të dorëzojnë dokumentet. Ministria e Financave u kërkon përfituesve të kështit të dytë të dorëzojnë në Drejtorinë e Pagesave numrin e llogarisë për të marrë dëmshpërblimin. Të gjithë personat kanë afati deri më



9 shkurt 2019 për të plotësuar dosjen.

DOKUMENTET

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shumica e dëmshpërblimit këthehet mbrapsht në buxhet duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, Emër/Mbiemër, apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një gërmë të vetme në krahasim me dëshminë e

trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medocemos që në të gjitha dokumentet emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatë e lëshuar nga gjendja civile. Në raste se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq.

EMRAT ME PERFITUESIT E KOMPENSIMIT TE TE PERNDJEKURVE

NK. DOSJES	EMER	MBIEMER	EMER	ATISIA	MBIEMER	KOPJETE LETER NOVOIT	NUMER PERSONAL LLOGARI BANKARE	CERTIFIKATE NDIKORE	CERTIFIKATE FAMILJARE	DESHIMI FRASHEG-MET	PRO-KURIE	CERTIFIKAT GJENJERA LITETESI
851	DIN	RAMAJ										
7127	NEZHIP	LAMCE										
			TERIK									
			MAJARI	LAMCE								
			RAKIBI	LAMCE								
			BARDEHI	LAMCE								
			MELIKI	BRAMIM								
			MUKADES	NEZHIP	KLOD							
			VEHETA	NEZHIP	SIHEU							
8616	TSOHIK	BEKTESHI	ALBERT	LAMCE								
			HASAN									
			LUMINI	BEKTESHI								
4239	MARK	NIKOLLI	HASAN	BEKTESHI								
			MARK									
			MARIE	TOM	NIKOLLI							
			MARIE	MARK	NIKOLLI							
			PREMERK	MARK	NIKOLLI							
8896	SHPRENA	CEKA	ZIFA									
			HASAN	CEKA								
			MAKJULE	HASAN	CEKA							
1862	MERSET	MALLIKA	HUREJDI									
			BOBEM	MALLIKA								
			IBRAHIM	SULEJLLA	GHISHO							
9750	SULEJMAN	MULLA	VELI									
			DRITAN	SULEJMAN	MULLA							
			VILA	SULEJMAN	MULLA							
6006	MIKEL	RADOVANI	CHS									
			DOMENIKA	NPOC	RADOVANI							
			ALIKET	MIKEL	RADOVANI							
2974	HASAN	RECI	SHAM									
			HASAN	RECI								
6664	GERIM	JAKUPI	HALLIT									
			LEMTURI	ISMAIL	JAKUPI							
			ADINAND	GERIM	JAKUPI							
			LENDITA	GERIM	MEFAITA							
3809	KOCO	KRISTO	KARIBUR									
			VASE	KOCO	KRISTO							
12170	XHEVAHIR	TURANI	KARAFIL									
			FUDAT	KARAFIL	TURANI							
9938	NAZMI	SHEHU	HAKIK									
			NAJIB	NAZMI	SHEHU							
			RENEP	NAZMI	SHEHU							
844	OLIVERA	DIJERA	MILLITIN									
			OSIDA									
			FATIME	OSIDA								
			ALVIN	RESHAT	OSIDA							
			OSIDA	RESHAT	OSIDA							
1235	PETRI	ASLANAJ	OSIDA									
			NEKI	OSIDA								
10327	PASHK	TOSKU	BRING									
			PASHK	TOSKU								
			DAVE	PASHK	RIKKA							
			DRANE	PASHK	RIKKA							
			NEDE	PASHK	TOSKU							
11501	SYRIA	PESHKOPJA	HALLIT									
			SYRIA	PESHKOPJA								
12684	NAMIK	HYSENBEGAS I	ZENEL									
			DIJERIE	RIFAT	HYSENBEGAS I							
			MERITA	NAMIK	HYSENBEGAS I							
			ANLA	NAMIK	HYSENBEGAS I							
			ZENEL	NAMIK	HYSENBEGAS I							
12870	XHAFFER	ZOTAJ	MELIQE	MALIQ	ZOTAJ							
			HEKTOR	XHAFFER	ZOTAJ							
			TEUTA	XHAFFER	BEGA							
			SHOHONIA	XHAFFER	ZOTAJ							
			LUAN	XHAFFER	ZOTAJ							
3614	METUSH	HOXHA	SHAHIN									
			HYSHIE	HOXHAJ								
			DIJERIE	METUSH	HOXHAJ							
			DIJERIE	METUSH	HOXHAJ							
			DIJERIE	METUSH	HOXHAJ							
			HYSHIE	METUSH	SHIRAMIRI							
			HYSHIE	METUSH	ISHIRI							
			BEKNIK	METUSH	HOXHAJ							
12002	KOCO	ZGJURI	DIJERIE									
			KEBIRI	ZGJURI								
			KEBIRI	ZGJURI								
			IRINA	KOCO	ZGJURI							
8294	RIZA	KUCI	HAKRI									
			ADRIAN	RIZA	KUCI							
			KRESNIK	HASIMIA								
9010	PROFI	COKA	JORGJI									
			BOGDI	PROFI	COKA							
			BESA	PROFI	NACE							
			NIKOLETA	PROFI	SKAKA							
4843	BEQOR	DIJERA	STAVRI	IBRAHIM	COKA							
			MYRTO	BEQOR	DIJERA							
			ILJAZANA	BEQOR	TAGA							
6806	MANISH	PESHKOPJA	MANISH									
			GEZIM	MANISH	PESHKOPJA							

4327	GYLSHAB	LEKA	SEKNER	IBRAM	LEKA							
			NASHI	IBRAM	LEKA							
			ELVIRA	IBRAM	ALIZITI							
4330	IBRAM	LEKA	SEKNER	IBRAM	LEKA							
			NASHI	IBRAM	LEKA							
			ELVIRA	IBRAM	ALIZITI							
10714	PETRO	TOMORRI	ALBERTA	SIMON	TOMORRI							
			IBRAM	PETRO	TOMORRI							
			ILIJAZ	PETRO	TOMORRI							
11705	ESHREF	SHAHMETI	IBRAM	SHAHMETI								
			BEHREZ	IBRAM	SHAHMETI							
			MBRAMET	ESHREF	SHAHMETI							
596	QERIM	LIMANI	ISAN	ESHREF	SHAHMETI							
			DEBRO	QERIM	SHAHMETI							
			PEJBE	QERIM	SHAHMETI							
			SEJDO	QERIM	SHAHMETI							
			SHEQO	QERIM	SHAHMETI							
460	PETRI	SPAHU	IBRAM	SPAHU								
			IBRAM	SPAHU								
			IBRAM	SPAHU								
			IBRAM	SPAHU								
			IBRAM	SPAHU								
12682	ZENEL	HYSENBEGAS I	NAMIK	ZENEL	HYSENBEGAS I							
1927	GJUMAN	CARBANI	TOMORRI	CARBANI								
12	PEJMI	FRANSHERI	SUZANA	FRANSHERI								
			SPARTAK	FRANSHERI								
423	SEID	LEKA	JAKUP	SEID	LEKA							
			QANJH	SEID	LEKA							
			MYZJEN	SEID	LEKA							
			SYME	SEID	LEKA							
222	RENXHIP	STAFJA	HEMINE	RENXHIP	ST							

Table with columns: ID, EDP, CAMI, KIMETE, EGJEM, CAMI, and various status indicators (X, V, P, F, etc.). Rows include names like MILEVA, PAVLINA, MIHIDA, etc.

Table with columns: ID, EDP, CAMI, KIMETE, EGJEM, CAMI, and various status indicators (X, V, P, F, etc.). Rows include names like JORDANKA, PAPA, NADKO, etc.

Çfarë e sfidon arsimin tradicional?

Nga Pëllumb Karameta

(vijon nga faqja 1)

... që kristalizohen me shpejtësi. Kjo bën që së pari, e mbi të gjithë, universitetet - si qendra të kërkimit shkencor - të mos shqetësohen thjesht e vetëm për autonominë e tyre. Pasi sfidat e zhvillimet, gjithnjë e më shumë, duket, po zgjerohen ndarjen ndërmjet atyre që diskutojmë dhe atyre me të cilat do duhet të merremi vërtet. Në vijim, disa argumente që ilustrjnë konstatimin.

1. Zhvillimi i parë. Shkolla e erës numerike (digjitale) është shkolla e shoqërisë ku sasi të konsiderueshme informacioni dhe dije arrihen me teknologjitë e reja. Por, kjo shkollë është dhe shkolla e shoqërisë ku kapacitetet për të arritur, përveçuesuar dhe përdorur informacionin janë të pabarabarta për grupe shoqërore në qendër dhe periferi të vendit. Ky zhvillim po krijon ndarjen ndërmjet atyre që përfitojnë potenciale të shumtë nga teknologjitë dhe rrjetet online dhe atyre që nuk i kanë këto mundësi. Më tej, konstatohet që ndarja digjitale po provokon një të dytë: ndarjen në dije, përderisa pjesë të rëndësishme të kësaj të fundit nuk mund të arrihen nga të gjithë. Kjo ndarje e dyfishtë - dixhitale dhe njohëse - sa vjen e bëhet më alarmuese. Kështu, teknologjitë e reja, në vend që të reduktojnë ndarjen mes atyre që i kanë dhe atyre që nuk i kanë këto mundësi, po rrezikojnë ta zgjerojnë akoma më shumë ndarjen. Çfarë mund të propozojnë universitetet për të amortizuar ndikimin e ndarjeve?

2. Zhvillimi i dytë. Koncepti i inteligjencës njerëzore po përjeton fazën e kalimit nga inteligjenca krejtësisht kognitive (njohëse), në inteligjencën e shpërndarë në burime të ndryshme njohëse ose jo, individuale apo të ofruara nga shoqëria. Modeli arsimor tradicional e ka konsideruar inteligjencën tipar të qëndrueshëm të mendjes, mbi të cilën "natyra" llogaritet se ndikonte shumë më tepër se sa "ushqimi" përmes edukimit. Thëk-si mbi pandryshueshmërinë e çoi shkollën të përqendrohej më shumë mbi çfarë nuk mund të ndryshonte në mendjen e subjektit, se sa mbi atë që mund të ndryshonte. Kjo ide është sfiduar nga shkencëtarët, të cilët sugjerojnë se vlen më shumë të perceptohet inteligjenca si tërësia e "zakoneve" të mendjes që mund të kultivohen. Kur ideja e vjetër të lihet mënjanë, do të shohim të çlirohen mjaft praktika arsimore të vryra. Shkollat do ta pësyn veten si të kultivojnë të nxënësit aftësinë për rigjenerimin e njohurive, intuitën ose ndjeshmërinë (empathy) etj., në vend që të shqetësohen për "menaxhimin e kohës mësimore" apo "strukturimin e testeve" për vlerësim; do mund t'i ndihmojnë nxënësit të ndërtojnë inteligjencën funksionale, praktike dhe të gjerë, duke u



përqendruar më pak mbi mësimet e pafundme rreth gjërave që transmetohen, analizohen, shpjegohen dhe përsëriten vazhdimisht.

Sot, gjithnjë e më shumë, po merren parasysh ndërveprimi i subjektit me situatat, ndërtimet e tij mendore, përmasat shoqërore dhe kulturore të nxënies, bashkë me natyrën kontekstuale të saj. Gjithnjë e më pak, po ngjallin interes modelet e mëdha shpjeguese dhe njësoj për të gjithë. Të rrallë janë sot kërkuesit në psikologjinë arsimore që do donin të identifikoheshin si "bihevizistë", "kognitivistë", "funktionalistë" apo diçka tjetër. Ajo që u intereson tani psikologëve, nuk është më "Nxënia" me N të madhe si objekt i përcaktuar dhe i pandryshueshëm, por aspektet shkencore të këtij procesi, të vendosura në një kontekst të dhënë. A nuk

është ky zhvillim, interesant për kërkuesit në universitete?

3. Zhvillimi i tretë. Ndryshimi i modelit tradicional për disiplinat shkollore. Ka dalë nga moda sistemi i ngurtë tradicional i Auguste Comte që përfshinte 6 disiplina shkencore, me pikënisje matematikën dhe skaj sociologjinë. Sepse disiplina të reja lindin dhe revolucionarizojnë rregullisht paradigmat shkencore të pranuar, p.sh., fraktalet e Mandelbrot po vënë në diskutim gjeometrinë e letrave të palosura, të cilat fëmijët i presin në kopsht.

Shndërrimet e shoqërive dhe evolucionit i dijeve janë madhështore dhe pëshëtojnë vazhdimisht përmbajtjet e nxënies në shkollën e cila, aktualisht, bazohet mbi parimin e transmetimit të dijeve të fiksuara dhe të pandikuara nga rrjedha e kohës. Edhe disiplinat

shkollore nuk mund të izoloohen më si "ishuj" të vegjël, nëpër programe studimi dhe vite shkollore. Tani, dialogu ndërmjet tyre është bërë i paevitueshëm. Rigrupimi i disiplinave në fusha nxënies kërkon qasjet ndërdisiplinore. Futja e situatave për nxënien aktive detyron përdorimin e burimeve që mobilizojnë dije me origjin disiplinore të ndryshme, por dhe të burimeve me natyrë materiale, njerëzore, trupore, emocionale-volitive etj. Ka ndryshuar deri vetë statusi i dijeve shkollore; ato nuk janë më absolute dhe nuk përbëjnë më prurjen e vetme për programet e studimit, as dhe të vetmin objekt të nxënies shkollore. Për më tepër, kur ka të dhëna të qarta që tregojnë se kontakti me sistemet abstrakte si algjebra apo gjeometria nuk i bëjnë më të rinjtë të zgjuar. Një studim madhor i David Perkins-it të Harvardit - figurë e shquar në botën e "inteligjencës që mund të mësohet" - ka treguar se, pas shkollës fillore, arsimiti thuajse nuk ndikon mbi mënyrën si mendojnë njerëzit në jetën e përditshme, nëse janë jashtë fushës së tyre të specializimit. Kur atyre iu kërkua të mendojnë rreth një çështjeje shoqërore të përgjithshme, si ndikimi i dhunës televizive mbi sjelljen e njerëzve, u konstatua se as vitet e shkollës së mesme, as vitet në arsimin e lartë dhe as tre vitet pas përfundimit të tij nuk bënë dot dallimin në cilësinë e të menduarit të personave (sqarim:

nëse studentët e diplomuar mendojnë më mirë se adoleshentët 15-vjeçarë kjo vjen, jo pse kanë "konsumuar" më shumë vite arsimimi, por se janë një grup mjaft më i përzgjedhur).

Kjo është tronditëse, por është e vërtetë. Ato 6000 orë të shpenzuara pas fillores, për të shkruar ese, për të ndërtuar grafikë dhe zgjidhur ekuacione, nuk e kanë përmirësuar mënyrën sipas të cilës mendojnë të rinjtë 18 vjeçarë, kur ata janë jashtë klasës ose sallës së provimit. E, nëse gjeometria, përkthimet mekanike nga gjuhët e huaja ose shumëçka tjetër, nuk përdoren kaq shumë dhe nuk ndihmojnë të mendoni më mirë në jetën reale, atëherë, saktësisht, për çfarë qëllimi zhvillohen? Çfarë mund të propozojnë universitetet për këtë?

4. Zhvillimi i katërt. Copëtimi dhe veçimi i përmbajtjeve të nxënies. Punëdhënësit, gjatë dekadës së fundit, po zbatojnë një organizim të punës të cilin shkollat duket se nuk është ende e gatshme ta kuptojë dhe t'i përgjigjet. Kurrikula, që i organizon përmbajtjet e nxënies shkollore sipas një hierarkie logjike temash mësimore, është farë pranë modelit tradicional të F. Taylor, për "ndarjen e punës në mikro-njësi" (në shek. XX, punëtori plotësonte vetëm detyra individuale dhe elementare). Zbërthim i detyrës në porcione të vogla, të përsëritshme dhe jashtë kontekstit ishte baza e punës në sistemin zinxhir, zbatimimi i të cilit është konvejeri në uzinë-ironizuar mjeshtërisht nga Ch. Chaplin në "Kohët moderne". Sot po zhvillohen qasje të tjera në mjediset e punës. Psh., në uzinat e reja të montimit të automobilave SMART puna është organizuar në skuadra që grupojnë specialist të fushave të ndryshme të ndërtimit të automobilave. Skuadra zgjidh të gjitha problemet, menaxhon projektin si një të tërë, deri në vlerësimin e cilësisë së automjetit të përfunduar. Prodhim i bëhet, kështu, projekti i skuadrës për një kohë të caktuar. Kjo qasje globale, ndërdisiplinore, nëpërmjet projektit dhe si përgjegjësi e skuadrës, i kthen tërësisht krahet ndarjes tradicionale të punës. Pedagogjia që i përgjigjet këtij modeli organizativ të punës nuk i përshtatet atij edhe pse ky organizim po fiton terren përherë e më shumë në ndërmarrje. Sot, bota e punës i bën të rrëzë shkollës dhe i kërkoi t'i formojnë ndryshe njerëzit.

Sigurisht, nuk është e lehtë të përcaktosh çfarë duhet të nxënë fëmijët dhe të rinjtë, çfarë do të nxënë të gjithë ata dhe çfarë mund të nxënë disa prej tyre, varësisht interesave dhe rrethanave. E vështirë është dhe përpjekja për të harmonizuar traditën tonë pedagogjike dhe nevojat e sistemit me risitë e zhvillimit. Sidoqoftë, zgjedhja e mënyrave të organizimit të ri të procesit të nxënies është sfidë që duhet përballur. Besojmë se universitetet do mund të ofrojnë ide për këtë.

Opinioni *i* Ditës

Nga Dritan Hila

(vllon nga faqja 1)

...të numëruara dhe unë nuk mund të rrija pa e parë për herë të fundit njeriun tek e cila shkoja pa tekligj dhe i ktheja shtëpinë së prapthi, në vogëli.

Ishte edhe në respekt të një burri, i cili pavarësisht se me një staturë dymetroshe, ku në kafkë i dallohej shenja e ciftës së shrapnelit dhe uniforma e ushtarakut e bënte më të frikshëm, ishte më i duruar se një dado angleze.

Ishte natë e ftohtë dimri dhe u nisa pasi autobusët e Sanatoriumit kishin pushuar ecejaket, me shpresë se në pavionin e saj nuk do gjeja shumë njerëz. Kur hyra, isha i veshur me xhakët dhe pasi i e pyeta, nëse ajo ishte Manushajja dhe përgjigjes së saj të trembur, "po", i thashë se unë isha Dritani, djali i Lulos, siç e thërriste vëllain e saj.

U përqafuam të dy dhe thesi me kocka që kisha mes krahëve dëneste dhe lotët e thatë më ftohnin faqen.

Nuk e mbaj mend se çfarë folëm, por kujtoj dorën e saj të kockë e lëkurë, që përkëdhelte kokën time dhe frazat mbjllëse të çdo fjalie "të keqen sa je rritur".

Në krevatin ngjitur ishte një grua e re. Kishin gjetur një me tu-

Historia e njeriut që çliroi Tiranën



berkuloz që të bënte raportin për mua dhe kush isha unë.

E lexova pas disa vitesh tek dosja ime e kuadrit, kur shefja e zyrës Sami, ma dha duke qeshur, se ishte shënuar takimi imi me gruan e një të dënuari të rrezikshëm.

Pas disa muajsh, Manushajja Prodana, halla ime vdiq. Njeriu që i ishte gjendur krah nënës së saj për të rritur vëllezërit e vegjël dhe që nuk kishte pranuar ta ndante armikun e popullit që kishte burrë, i mbylli sytë në Sanatoriumin e Tiranës, nga turbekulozi që mori në internim.

Ishte me fat, nëse ky mund të quhet fat, pasi të tjerë kishin vdekur pa pasur njeri tek koka.

Disa ditë pasi u varros, nga burgu erdhi edhe letra e burrit të saj për gjyshen time.

Ishte letra e njeriut që kishte parë t'i vdisnin njerëz në duar, që kishte hedhur njerëz drejt vdekjes e që vdekjen e kishte parë në sy me dhjetëra herë.

Por që i puthte nga larg duart dhe i kërkonte falje për dhimbjet që i kishte shkaktuar dhe shprehte dashurinë dhe mirënjohjen për vazhën që kishte rritur dhe qëndruar

besnike në të mirë dhe në të ligë.

Ishte Muhamet Prodana.

Sot që vitet kanë shkuar, ai prehet në të njëjtin varr me të shoqen, duke u bashkuar me të në një botë më të mirë, sesa ajo që ai shpresonte të bënte. I një bote për të cilën kishte dalë që në të ri, maleve dhe nuk ishte tërhequr edhe kur kushëriri i tij, prefekti i Korçës i kishte thënë "kthehu nga mali ose të vrava". Që kishte vënë kokën në satër për njeriun, i cili më vonë do ta burgoste dhe përndiqte deri ditën që vdiq e më pas, si një mallkim.

Halla ime vdiq në 16 nëntor.

Në 17 Nëntor, dyzet e ca vjet më parë, në krye të Brigadës së I Sulmuese, burri i saj kishte hyrë në Tiranë për të sjellë një botë të re. Vështirë se do ta ketë imagjinuar kur ecte mes timit të makinave që ende digjeshin, të vrrarëve ende të pambledhur dhe mureve mbushur me plumba, se njeriu që po i hapte rrugën të hynte në Tiranë si shef i qeverisë, 30 vjet më vonë do t'i hape dyert e burgut dhe shkatërronte familjen...

Kanë kaluar shume vite, por sot është dita e tij, burrit që çliroi Tiranën.

HOROSKOPI

DASHI

Duhet t'i nënshtroheni një regjimi ushqimor dhe të kryeni ushtrime fizike, pasi e keni mjaft të nevojshme. Do të keni dëshirë të fitoni më shumë para. Mos u tregoni të ashpër me njerëzit që iu rrethojnë.

DEMI

Mosrehatia mund t'ju shkaktojë stres, por një miku juaj do t'ju ndihmojë të zgjidhni problemet. Dëgjoni muzikë dhe përqipuni të relaksoheni. Ka gjasa të dilni me miqtë tuaj dhe të argëtoheni, por bëni kujdes të mos ndani sekretet me të tjerët.

BINJAKET

Duhet të gjeni kohë rrafsueshëm për tu relaksuar, pasi lodhja mund t'ju çojë drejt pessimizmit. Gjendja juaj financiare do të përmirësohet, megjithatë nuk do të keni mundësi të realizoni plotësisht projektet që dëshironi. Fëmijët t'ju kërkojnë më shumë vëmendje.

GAFORJA

Do të ndiheni shumë mirë nga gjendja shëndetësore, pavarësisht se do të kaloni një ditë të lodhshme. Rritja e papritur e shpenzimeve do t'ju shqetësojë. Dita e duhur për të komunikuar me disa persona që i takoni rrallë.

LUANI

Puna juaj do të vlerësohet sot, pavarësisht se do të përballemi me një situatë shumë të vështirë. Mos e humbni kontrollin, ndërkohë që do të ndërmerrni një vendim shumë të rëndësishëm. Do të keni të gjithë vëmendjen nga partneri/partnerja juaj.

VIRGJERESHA

Presioni nga shefat në punë dhe problemet në shtëpi do t'ju shkaktojnë stres. Përpiciu t'ju kushtoni më shumë kohë prindërve dhe të këshilloheni me ta. Për çiftet e martuara, parashikohet një ditë mjaft e këndshme.

PESHORJA

Kushtojni më shumë rëndësi shëndetit tuaj. Mund të keni një rritje të papritur të shpenzimeve gjatë ditë të sotme. Bashkëshorti/bashkëshortja juaj mund të ketë probleme me shëndetin, çfarë do t'ju shqetësojë edhe juve.

AKREPI

Do të kënaqeni pafund nëse do të dilni në mbrëmje me miqtë. Duhet të bëni pak pushim nga axhendja juaj ditore. Qëndroni larg thashethemeve, pasi mund t'ju sjellin probleme. Ka gjasa që të debatooni me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj dhe problemet t'ju zgjasin për një kohë të gjatë.

SHIGJETARI

Miqët mbështetës do t'ju bëjnë të lumtur. Shmangni personat që ju afrohen për t'ju kërkuar borxh. Me familjen do të shpenzoni më shumë kohë se zakonisht, çfarë do t'ju kënaqë pamasa. Ka gjasa të nisni një marrëdhënie të romantike.

BRICJAPI

Do të ndiheni të mbushur plot energji. Përfitoni nga koha e lirë për të ndihmuar familjarët. Romanca do t'ju udhëheqë zemrën dhe mendjen. Tregohuni të kujdesëshëm me sendet tuaja personale.

UJORI

Bëhuni të fortë pasi do të përballemi me disa vështirësi, përndryshe mund të përfshihen në probleme. Vegërisht kontrolloni nervat, sepse më pas mund të pendoheni. Gjërat nuk do të shkojnë ashtu siç do të dëshironit ju sot.

PESHQIT

Shmangni stresin, pasi vetëm kështu mund të zgjidhni problemet me të cilat mund të përballemi. Përpiciu të mos shpenzoni jashtë buxhetit tuaj, mbi të gjitha për artijë që nuk janë të domosdoshëm. Bëni mirë që të falni disa gabime nga e kaluara.

Fjalimi *i* Ditës

Fjala e Papës Françesku shqiptarëve për Gjergj Kastriotin Skënderbeun

Të dashur vëllezër ipeshkvij e meshtarë, vëllezër e motra,

Me kënaqësi të veçantë, ju uroj mirëseardhjen juve, që keni ardhur këtu me rastin e 550-vjetorit të vdekjes së heroit tuaj kombëtar, Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Përsëhendes me mirënjohje të pranishmit dhe, me mendje, edhe gjithë shqiptarët, në atdhe e në vende të tjera të botës, të cilët, në emër të lidhjeve të lashta të miqësisë e të marrëdhënieve të vazhdueshme, e shohin gjithnjë me dashuri Selinë e Shën Pjetrit. Në këtë kuadër, më pëlqen të kujtoj se 50 vjet më parë, Shën Pali VI deshi të presë një përfaqësi të shqiptarëve.

Shqipëria, tokë me histori të lashtë e të lavdishme, është pjesë përbërëse e Evropës dhe përmes traditave të saj më fisnike e më jetësore dokumenton zanafillën e vetë qytetërimin të saj. Sot, kujtojmë e kremtojmë Gjergj Kastriotin Skënderbeun, bir heroik i një populli të fortë e bujar, që mbrojti me guxim vlerat shpirtërore dhe emrin e krishterë, aq sa të meritonte titullin "Athleta Christi". Me vepër e tij, farkëtoi identitetin kulturor shqiptar, duke u bërë simbol i padiskutueshëm lidhjeve dhe bashkimit kombëtar, si edhe interpretues në nivelin më të lartë i vlerave të besnikërisë së ndershme ndaj impenjimeve të ndërmarrta lirish.

Rëndësia e veçantë e figurës dhe e vepërës së Kastriotit përfaqësohet mirë në flamurin tuaj, me

shqiponjën e zezë dykrenore në sfondin e kuq, bërë sipas stemës së heroit. Pak herë në histori, një individ i vetëm ka arritur t'i mishërojë kaq qartë e kaq gjerësisht virtytet e një populli, deri në atë pikë sa është e vështirë t'i kuptohet shpirti, pa u ndalur e pa marrë parasysh parimet dhe vlerat, që e frymëzuan atë personazh të veçantë.

Pas vdekjes së heroit dhe pas pushtimit të Shqipërisë, shumë shqiptarë preferuan të emigrojnë dhe shumë prej tyre u vendosën në Itali, në qendër të gadishullit e në jug, sidomos në Kalabri e Sicili, duke u dhënë jetë Rrethëve kish-tare shqiptare të Ungërës, të Horës së Arbëreshëve dhe të Grottaferatës.

Prania, në takimin e sotëm, të një grupi arbëreshësh, pra, italo-shqiptarësh, me traditat dhe shprehjet e tyre gjuhësore përçaruar prej shekujsh, na bën të imagjinojmë atmosferën e Shqipërisë së Skënderbeut dhe na konfirmojnë se heroit kombëtar mbetet urë e vlefshme për ruajtjen e lidhjeve të frytshme të arbëreshëve me tokën e tyre të origjinës.

Për arsye të rëndësishme të veçantë të figurës dhe të vepërës së gjithanshme të Gjergj Kastriotit Skënderbeut, kuptohet më së miri se Shqipëria ka dashur ta shpallë

këtë vit, "Vit mbarëkombëtar të Skënderbeut".

Uroj me gjithë zemër që ky përvjetor të mos kufizohet në kremtimin e lavdisë së veprave të kaluara, por të jetë për Shqipërinë edhe rast i vulltshëm për impenjimin e risuar të të gjithëve - institucione e qytetarë - në favor të një zhvillimi të vërtetë e të ekuilibruar, në mënyrë që brezat e rinj të mos detyrohen të zgjedhin emigracionin, duke e dobësuar vendin nga forcat dhe aftësitë e domosdoshme për zhvillimin e tij njerëzor e civil.

Puna e përbashkët e të gjithëve drejt këtij objekti do të bëhet mënyra më e mirë për të mishëruar në kohën e tanishme, dashurinë për atdheun, që frymëzoi Gjergj Kastriotin Skënderbeun, në kohën e vet. Ai, duke interpretuar sa më mirë karakterin dhe traditat e popullit tuaj, shprehu vlefshëm shqiptarinë, term i përdorur nga shkrimtari i shekullit XIX, Pashko Vasa, për të treguar identitetin shpirtëror, që i bashkonte të gjithë shqiptarët, përtej dallimeve me natyrë fetare. Në Shqipëri, kjo bindje i dha shtysë bashkëjetesës paqësore ndërmjet njerëzve, që u përkasin feve të ndryshme, duke u kthyer me kohë në bashkëpunim e vëllazërim.

Siç pata rastin të pohoj, me rastin e vizitës sime në Shqipëri, "klima e respektit dhe e besimit të ndërsjellë ndërmjet katolikëve, ortodoksëve e myslimanëve është pasuri e çmueshme për vendin" (Takimi me autoritetet, 21 shtator 2014: Insegnamenti II, 2 [2014], 271). Ajo tregon se bashkëjetesa paqësore ndërmjet njerëzve, që u përkasin feve të ndryshme, është rrugë, e cila mund të përkshohet konkretisht, sjell harmoni dhe çliron forcat më të mira e krijimtarinë e mbarë popullit, duke e shndërruar bashkëjetesën e thjeshtë në bashkëpunim e vëllazërim të vërtetë. Gatishmëria për t'i konsideruar ndryshimet si rast për dialog, vlerësim e njohje të ndërsjellë, favorizon gjithashtu, zhvillimin e udhëve shpirtërore të vërteta e bëhet shembull i vlefshëm, për t'u parë me interes të madh në ndërtimin e një paqëje të qëndrueshme, themeluar mbi respektimin e dinjitetit të njeriut.

Duke përkujtuar me mirënjohje shenjtoretë martirë, që e dëshmuar fenë me çmimin e jetës, si edhe shën Terezën e Kalkutës, me kënaqësi, i jap Bekimin Apostolik secilit prej jush, këtu të pranishëm, familjarëve tuaj dhe gjithë popullit shqiptar. Një favor, mos harroni të luteni për mua. Falënderim!

Mbrojtësi kërkon të ulë tensionet

Mavraj: Me Uellsin do të fitojmë për trajnerin

Kapiteni i Kombëtares, Mërgim Mavraj ka dalë para mediave në prag të takimit ndaj Uellsit, duke u shprehur se pavarësisht rezultateve ekipi është në mbështetje të trajnerit.



kanë treguar që në kohë të vështira janë treguar të fortë. Futbollit nuk është vendi i duhur për të treguar trimëri, të marrësh gjithë përgjegjësitë.

jemi me të. Ndoshta, nesër (sot) do të luajmë edhe për trajnerin tonë. Përkrahjen tonë e ka. Kur dalim në fushë nuk është se nuk e përkrahim trajnerin, nuk luajmë as kundër e as për inat, as nuk gabojmë.

futbollit dhe nuk ka lidhje pse trajneri u largua, erdhi, ngeli. Ne mundohemi, nuk është se nuk mundohemi, ajo që ndodhi ishte ndoshta nga mbingarkimi, kishim dëshirë të madhe për të fituar, nuk mendoj se kemi luaj-

tur kundër trajnerit apo nuk kemi bërë çfarë ka thënë trajneri. Mënyra e lojës ka ndryshuar komplet, siç kemi luajtur është nata me ditën. Nuk ka më mirë apo më keq, nuk na takon të vlerësojmë, kemi bërë ndryshim, kemi qarkulluar me shumë topin. Ka hapësira për kundërshtarin, jemi duke u fokusuar në një repart, por është mënyra e lojës që ka ndryshuar. Kur bën presing, krijon hapësira dhe nuk na ndodh vetëm ne", - u shpreh Mavraj.

Jeton Selimi



Topi tashmë është në mesfushën e presidentit të FSHF, që duhet të marrë përsipër dëmshpërblimin

Panuçi: Nuk e jap dorëheqjen, pyesni më mirë Dukën!

Trajneri i qartë, qëndron deri në fund të kontratës

Kristian Panuçi nuk ka ndër mend të dorëhiqet. Në konferencën e djeshme për shtyp, ku pati dhe një moment tensioni me gazetarët prezentë, trajneri italian ritheksoi edhe njëherë qëndrimin e tij të post Skocisë, porse kësaj radhe shkoi më tej, duke sfiduar direkt rezultatin e FSHF-së, Armando Dukën.



në karakterin tim. Nuk i stërvit dot ditë lojtarët. Duhet të trajnosh sa më pak të jetë e mundur me ndryshimet e lojtarë. Shumë ekupe big kanë rënë nga Liga, nuk kam dëgjuar për ndërrimin e trajnerit, kjo është gjeja e fundit që diskutohet. Në Kombëtare nuk ka asnjëherë provë, jemi përpjekur të sjellim një ide, por nuk shko mirë. Koha për të punuar është, pastaj nëse e bëj unë apo jo merrni Dukën në telefon e pyeten është apo jo Panuçi. Unë kam kontratë deri në nëntor 2019, nëse shkoj në Europian vazhdoj, në të kundërt kthehem në shtëpi. Kam respekt për punën dhe kush më paguan. E vuaj shumë dhe nuk e lë të shihet, rri i ekuilibruar.

time. Nuk mund të nis të jap për këto rezultate. Duhet të shoh përpara. Jam i lumtur që jam këtu. Nëse do të ishit ju në vend të Dukës, çfarë do të bënit me Panuçin? Përqindjet i bëni ju, si gazetarë. Për Dukën, nuk di ç'të them, nuk përgjigjem dot në vend të tij. Megjithatë, nuk e përmendi fare që kundër Ukrainës e Kosovës mungonin 14 lojtarë. Nuk dua të gjej justifikime, por më thonin një kombëtare që funksionon pa gjysmë skuadër. Shihni Italinë, për shembull, sa po vuan. Duhet një fitore ndaj Uellsit, çfarë do ndryshojmë që nesër, emrat në fushë? Kemi 16 lojtarë dhe do të mundohemi të hedhim në fushë lojtarët në gjendje të mirë, por nuk ka hapësira për ndryshime të mëdha. Kthehen Hysaj e Basha, por kemi disa lojtarë të dëmtuar. Kur kemi folur me skuadrën, çfarë keni biseduar në lidhje me të ardhmen? Takimet tona janë takime private, flasim shumë. Jemi në

të njëjtën varkë dhe në këtë moment varka është në det të trazuar, duhet ta kthejmë në ujëra të qeta. Zhgënjimi më i madh deri tani? Çdo humbje më zhgënjën, zhgënjim i madh është që nuk fituam grupin në Nations League. Keni folur me presidentin? Jo nuk kam folur akoma me presidentin. Plani B është nëse nuk dëmtohen lojtarët? Unë grupin e kam në mendje, kam 6-7 lojtarë të dëmtuar që nuk janë. 8 lojtarë që kanë luajtur ndaj Skocisë nuk luajmë me klubet e tyre. Për ju nuk ka rëndësi, por për mua është problem i madh. Duhet të mundohemi të bëjmë maksimumin e mundshëm, por ideja e futbollit ofensiv që kisha në mendje ka rezultuar e gabuar nga ana ime. E keni telefonuar mbrojtësin që aktivizohet në Argjentinë Tomas Guidara? E di kush është, e kam parë, por nuk e kam telefonuar kurrë. Mos ndoshta duhet parë më shumë nga kampionati shqiptar? Kam thirrur Gavazajin, Gurin, Lilajn, Abazajin. Nëse nuk luajmë në klubet e tyre nuk kam si i thërras. Gavazaj dhe Lilaj ishin të Skënderbeut, Guri të Kukësit. Për çfarë do shërbejë ndeshja e nesërme (sotme), për lojë, lojtarë të rinj, apo rezultat? Kombëtarja mbetet kombëtare, duhet luajtur për të fituar çdo ndeshje, por kjo ndaj Uellsit është pak më delikate. Lojtarët duhet të luajmë për të zhvilluar një ndeshje serioze, sepse kur humbasim, humbasim të gjithë. Të shohim nesër.

Si është raporti juaj me presidentin e FSHF? Keni biseduar me Dukën, kjo është ndeshja e fundit, apo do vazhdoni? Këtë pyetje bëjani Dukës, mos ma bëni mua. Unë jam trajneri i Kombëtares dhe normalisht kam pozicionet dhe detyrat e mia. Këtu ka shumë të vërteta që nuk ka asnjë interes për t'i thënë, duhet të zgjidhim problemet e ekipit. Si mund të dilët nga ky tunel? Unë jam përgjegjës absolut për këtë moment të vështirë. Kush thotë që kemi një vit e gjysmë që nuk ecim mirë, u kujtoj që e mora Shqipërinë në vendin e katërt dhe dolem në vendin e tretë. Nga tuneli dilët duke punuar. Askujt nuk i intereson të thotë sa lojtarë i kanë munguar Shqipërisë në 1 vit e gjysmë. Gjermania doli e fundit në Ligën e Kombeve, imagjinioni çfarë mund t'i thonë të shkretit Lëv. Imagjinioni që 10-12 lojtarë që grumbulloj nuk luajnë as në klubin e vet, askujt nuk i ka interesuar kjo gjë. Këtu mendojnë se Shqipëria shkoi në Euro 2016 dhe duhet të kualifikohet çdo vit. Jam i bindur se Shqipëria mund të pretendojë kualifikimin në Europian, por vetëm nëse është e plotë. Duke qenë se unë jam përgjegjës i vetëm, jam përpjekur të sjell diçka ndryshe. Duke qenë se janë njerëzit arrogantë dhe nuk ndryshojnë mendim, nuk kam asnjë problem të them që duhet të ndryshojmë patjetër. Nuk kam kohë të punoj me skuadrën, t'i jap një kondicion fizik, nuk kam as kohë të bëj futboll të evoluor dhe duhet të bëj diçka ndryshe. Historia thotë një të vërtetë tjetër dhe duke qenë se unë nuk jam budalla, duhet të ndryshoj.

Padyshim, sepse, nëse vazhdojmë në këtë rrugë, i vë në vështirësi lojtarët. Çfarë do të ndryshojmë, duke filluar që nesër (sot)? Nesër (sot) do të duhet një ulërimë nga lojtarët, duhet të tregojnë atributet e tyre. Dëgjoj një stadium që ofendon me të drejtë, jam një person seri-

oz dhe e vuaj shumë këtë gjë. Kam gabuar në këtë vit idenë e futbollit që duhet të sillja. Prandaj do të ndryshojmë dhe shpresoj të shkojmë në një rrugë që do të jetë e dyta. Mos ndoshta keni gabuar që keni qenë euforik? Nuk kemi treguar atë që ne jemi si Kombëtare. Kjo peshon

TRAJNERI I UELLSIT

Gigs: Shqipëria luajti mirë kundër Skocisë për... 22 minuta!

Rajan Gigs ka dalë në konferencën për shtyp para ndeshjes që Uellsit që drejton legjenda e futbollit botëror, do të luajë kundër Shqipërisë. Ish-mesfushori mendon se kuqezi do të jenë shumë më të mirë ndaj ekipit të tij, ndërsa i ka vlerësuar për minuta e parë ndaj Skocisë. "Kam mundësinë që të provoj disa lojtarë të rinj pasi kjo ndeshje ta lejon. Do të bëj të gjitha zëvendësimet e mundshme në këtë duel. Kemi ardhur për të fituar këtu. Do e shoh nëse luan apo jo Bejl, është një lojë si të tjerët. Do e shoh para ndeshjes e

mund të luajë, nuk ka asnjë problem fizik, ndaj është i gatshëm. Ganter nuk di ende se ku do ta aktivizoj, por do të jetë titullar. Do të luajë një ndeshje historike, do të thyjë një rekord të vendosur shumë vite më parë. Do të jetë një ndeshje e madhe për të. Golim kundër Shqipërisë në 1994, të them të drejtën nuk e mbaj mend aspak. Duhet të kisha mbajtur mend se nuk kam shënuar shumë gola. Ka shënuar edhe Koleman? Si ka mundësi, të paktën të tijin duhet ta mbaja mend. Duket qartë që më ka humbur me-


moria. Do të jenë 1200 tifozë që do të mbështesin skuadrën tonë në këtë ndeshje dhe ne e vlerësojmë në maksimum këtë gjë. Nëse humbasim kundër Shqipërisë nuk është diçka e madhe. Shqipërinë e pashe kundër Skocisë dhe janë një skuadër shumë solide. Në 22 minuta të para bënë një ndeshje shumë të mirë dhe të dyja skuadrat mund të shënonin. Po ishin të pafat. Pres një reagim nga Shqipëria dhe jam i sigurt do të bëjnë maksimumin kundër nesh", - tha Gigs.

UEFA CAKTON ARBITRAT

Shqipëri-Uells, gjykon një treshe maqedone

Shqipëria do të luajë sot miqësoren në "Elbasan Arena" ndaj Uellsit, në orën 20:00, ndërkohë që UEFA ka zyrtarizuar edhe gjyqtarin që do të vërd drejtësi në këtë takim. Trupa e arbitrave do të jetë nga Maqedonia, me kryesor Dejan Jakimovski, dhe asistentë të tij Nikola Karakolev dhe Kushtrim Lika. Ky i fundit, vjen nga Komuna e Kërçovës në Maqedoni, një komunë e pjesës perëndimore të Maqedonisë, ku shqiptarët përbëjnë popullsinë më të vjetër autoktone. 33-vjeçari Jakimovski ka qenë edhe një herë tjetër në gjykimin e Shqipërisë, në miqësoren e 5 marsit të 2014-ës, ndaj Maltës, ku kuqezi fitoi me shifrat 2-0, falë golave të Bashës dhe Mehës.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Pupi regjisor.
- Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj persëve
- Turner aktore.
- Fillojnë festat.
- Skuadër greke.
- Falen pa fe.
- U shkrua nga Gorkij.
- Një sterë për... model.
- Janë bisha.
- Parashtesë për dy.
- Demoni që persekutonte Sarën.
- Stacion i famshëm orbital.
- Mendes regjisor.
- Një rreth i ngushtë miqësor
- Film me Robert de Niro dhe Jean Reno
- Këndohen në opera.
- Është lajm i vjetër.
- Sharif aktor.
- Martin i Norma Rae.

- Mund të jenë filmi.
- Një jepet për hartim.
- Ami i Maupassant.
- Fundi i Turandot.
- Hallit këngëtare.
- Neill i Jurassic park.
- Pineda e Garcia Lorca-s.
- Giorgio stilist

VERTIKAL

- Morissette këngëtare.
- Kilmer aktor.
- Heche aktore.
- Fillojnë tatëpjetën
- Është diapozitiv shumë i ndjeshëm.
- Mbyllin spitale.
- Në krye të masave.
- Bëjnë shirit me shi.
- Qe vajza e Tantalit.
- Janë më shumë se dëshira
- Ishte dekret i sulltanit.
- Qe mbreti i urtë i Pilos.
- Quinn aktor.
- Gasol i NBA.
- Fillojnë garën.
- Një pjesë e reformave.
- Është si biskotë.
- Mund të jetë karmelitan.
- Sjellin shi.
- Bel i Maupassant.
- Direk pa ekstreme.
- Gjysma e bimëve.
- Mbyllin një motor.
- Është bitum.
- Fara këngëtare.
- Hanks aktor
- Stiller aktor.
- Morrison rockstar.
- Fillojnë masat.
- Në krye të tabelës.
- Derisa janë në fund.
- Fund filmi.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

- Film i hitchcock.
- Fillojnë premierën.
- Janë legjendat.
- Kush ka... ka zët.
- Thurman aktore.
- Një pjesë e testamentit
- Një pjesë e studimeve.
- Kështu është situata e tensionuar.
- Telefoni në kartëvizitë.
- Është ngasje.
- Në krye të autoriteteve.
- Mbyllin mbledhjen.
- Pason abetaren.
- Nisin nga kreu.
- Fillojnë aafirimin.
- Cocker këngëtar.
- Bartok kompozitor.
- Tiriac që qe tenist.


- Oxa këngëtare.
- Kalimi në ekstreme.
- U shkrua nga Zola.
- Fise pa fe.
- Është mballomë.
- I mungon apatikut.
- Një pjesë e medaljeve.
- Një këngëtar lirik.
- Pak torturuese.
- Ka privilegjin e jetës.
- I famshmi Pacino.
- Nasi shkrimtar.
- Janë temperaturat më të ulëta.
- Me pit në box.

VERTIKAL


- Janë enigmatikë.
- Emri i Vivaldit.
- Rrjedh në klepsidër.
- Inicialet e Selleck aktor.
- Fillojnë rubrikën.
- Ishte babai i Proknit dhe Filomelës.
- Vitet pa kufij.
- Mbyllin kanate.
- U shit për një pjatë thjerza.
- ... e shëndoshë në trup të shëndoshë.
- Moore aktore.
- Rocca aktore.
- Janë përmasa.
- Janë dhjetori.
- Mbyllin krahum.
- Fillojnë kalimin.
- Duhen ruajtur.
- Ishte Europa komuniste.
- Agjenci Kombëtare Lokale
- Berg kompozitor.
- Të parat në Amsterdam.
- Elsa këngëtare.
- Memoria në computer
- Me të nxjerrin trarë.
- Në mes të dhomës.
- Ekstreme kateti.
- Kufijtë e luftës.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

8		5			6	1	4		
3									2
1	6	9		7	4		5		
	4	5		2					
9		3					4		
6	2	1			8	9			
		8	1						
4				6					
				3	9	8			

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	5	1	9	6	2	7	8	3	
7	8	6	1	3	4	2	9	5	
3	2	9	5	7	8	1	6	4	
5	9	2	7	4	3	8	1	6	
6	7	4	8	5	1	9	3	2	
8	1	3	6	2	9	5	4	7	
1	3	7	2	9	6	4	5	8	
2	4	8	3	1	5	6	7	9	
9	6	5	4	8	7	3	2	1	

Argëtim filozofik

-Më mirë të jesh endacak e të udhëtosh vetëm, sesa të mykesh në shoqëri e budallenjeve.

-Lëviz nëpër botë duke festuar, kërcyer, kënduar, si një bletë; shko nga lujja në lule, vetëm duke provuar të gjitha eksperiencat, pëiqesh.

-Vdekja do jetë shumë e bukur nëse di të komunikosh me të. Është një shpërbërje, bie prapë në burimin e qënies për tu clodhur e për tu rinovuar. Do të thotë, të zhdukesh në burimin e ekzistencës dhe të bashkohesh me Zotin - dhe mund të rilindësh prapë, deri sa të bëhesh i Zgjuar.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

5	1	11	18	3	10	18	2	1	15	20	T	E	K	B	O	M	B	R	E	D	H				
3	2	6	5	3	2	1	5		1	13	1	O	R	A	T	O	R	E	T	E	S	E			
21		4	3	5	6	2	1	5		5	10	5	G	N	O	T	A	R	E	T	T	M	T		
1		6	10	1	2	9	11	6	4	1	5		E	A	M	E	R	I	K	A	N	E	T		
2	13	7		2	1	5	1		1	2	8	11	R	S	L	R	E	T	E	E	R	I	K		
	19	1	7	3	5	6		15	14		10	6	P	E	L	O	T	A	D	V	M	A			
13	3	5		2		5	6	11	1	1	5	T	S	O	T	R	T	A	R	E	T	E			
5	2					21	19	6	2	1	5	E	T	R	G	P	A	R	E	T	E				
1	5	7		6	2	8	5	10	8	6			E	T	L	A	R	I	T	M	I	A			
16	8	7	8	17	6	5		1	6		21	6	F	I	L	I	Z	A	T	E	A	G	A		
6				15	8	5	1	5				18	3	A	D	I	T	E	T	T	O	M			
4	3	18	8	7	6			18	6	4	6	7	1	N	O	B	I	L	E	B	A	N	A	L	E

- Për të parë atë që pak njerëz kanë parë duhet të shkoni aty
- ku pak kanë qënë .
- Përgjuesi është i ngjashëm me atë që hedh pluhur kundër dikujt tjetër kur era
- është në drejtim të tij ; kështu pluhuri s'bën gjë tjetër veçse i kthehet atij që e hodhi

- I virtutshmi nuk mund të plagoset dhe
- dhimbja që tjerët duan t'i shkaktojnë , bie mbi vetë ato .
- Mos i beso asgjëje , s'ka rëndësi ku e ka dëgjuar ose kush e ka thënë , edhe sikur ta kem thënë unë , vetëm nëse është e pranueshme dhe e kuptueshme për arsyen tënde .

Thënie të mençura

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

A	V	A	T	I	S	A	L	A	M	I	N	A
L	A	N	A	F	E	E	A	R	I	S		
A	L	N	E	N	A	P	A	T	O	P		
N	E	G	E	R	S	I	R	A	T	B	I	
I	N	A	S	M	O	D	E	U	M	I	R	
S	A	M	T	A	R	A	F	A	R	K	E	T
M	B	E	R	I	N	O	M	A	R	E	T	
H	X	B	E	R	I	S	E	R	I	T	E	
R	I	T	B	E	L	I	T	E	V			
T	E	M	E	B	E	L	I	T	E	V		
O	T	M	E	R	I	T	A	S	A	M		
M	A	R	I	A	N	A	A	R	M	A	N	I
M	A	R	N	I	E	P	R	M	I	T	E	
I	N	A	T	U	M	A	D	T	E	S		
S	T	U	S	E	N	D	E	R	E	A		
T	E	L	T	U	N	D	I	M	I	S	A	U
E	N	K	E	N	D	I	M	I	S	A	M	
R	A	A	F	J	O	E	B	E	L	A		
I	T	A	A	A	N	N	A	K	E	I		
O	K	A	N	A	I	S	A	R	N	A		
Z	E	L	L	I	L	I	M	E	D			
T	E	K	B	A	R	I	T	O	N	T	O	R
T	O	K	A	L	L	E	R	A				
M	I	N	I	M	A	L	E	S	T	E	R	

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

